

# GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI  
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA  
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXIV - Nr. 7723 E mërkurë 28 Nëntor 2018 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

**Opinion** *i* **Ditës**  
Në Pejë, duart e dy kryeministrave shqiptarë u bashkuan mbi flamurin kombëtar, por që nga pavarësia e Kosovës në shkurt 2008, po bëhen më shumë se ...  
Vijon në faqen 20

Nga FATOS ÇOÇOLI  
**Integrimi ekonomik Kosovë-Shqipëri, si patriotizëm prej vërteti**  


**Opinion** *i* **Ditës**  
Pak ditë më parë Edi Rama i tha një televizioni gjerman se ai ishte artisti më i mirë mes politikanëve shqiptarë. Në mbledhjen e përbashkët të dy qeverive ...  
Vijon në faqen 21

Nga ANDI BUSHATI  
**Regjisori i dy qeverive**  





Lista/ Kësti i tretë për trashëgimtarët  
**Të përndjekurit, 1400 emrat që do marrin paratë në të gjithë vendin**

Ministria e Financave publikon përfituesit. Dokumentet që mungojnë në dosjen e secilit  
Rreth 1400 trashëgimtarë të ish-dënuarve politikë që pinsin të marrin këstin e tretë duhet të plotësojnë dokumentacionin që u mungon në dosje për të marrë më pas paratë. Lista është bërë publike dhe nga Ministria e Financave. Bëhet fjalë për përfitues të kategorisë jo parësore që do të trajtohen me dëmshpërblim, por që ...  
Në faqet 10-11

## EKSKLUZIVE/ AKADEMIKU REXHEP QOSJA: KJO IDE ESHTË MENÇURI POLITIKE "SHKËMBIMI I TERRITOREVE SJELL PAQEN KOSOVË-SERBI"

"Shkëmbimi në paqe i veriut të Mitrovicës me Luginën e Preshevës është zgjidhje historike. Kjo hap rrugën e bashkimit të Kosovës me Shqipërinë"



(Në foto) Akademiku, Rexhep Qosja

**OPINION**  
Skënderbeu dhe flamuri kombëtar në mistikën e numrit "33"  
ALBERT HITUALIAJ  
Në faqen 9

**SAMITI I TURIZMIT**  
Blendi Klosi vlerëson "Prestige Resort". Arkitekti: Vitin tjetër, park ujor  
Në faqen 5

**PROTESTA E BANOREVE**  
Kryemadhi: Unaza e Re? Deputetët e PS-së të shkojnë tek ata që kërkuan votat  
Në faqen 2

**RRREFIMI I STILISTES**  
Stela Sallaku: Moda, më pëlqen stili i veshjes në vitet '50-'60  
Suplement

**UNIVERSITETI**  
**Mbrojtja e grave nga dhuna, 'Luarasi' i bashkohet nismës "Orange the World"**  
Në faqen 8

Banorët tek Unaza e Re përplasen me policinë. 107 familje përjashtohen nga legalizimi  
**Protestuesit: S'tërhiqemi. Rama: Mos dëgjoni SHQUP**  
Veliaj: Rrisim bonusin e qirasë. Basha: Gati për betejë me qeverinë

Banesat sociale të Bashkisë së Tiranës në Shkozë priten dhe dy familjet e para që preken nga projekti i Unazës së Madhe. Kryeministri Edi Rama përgëzoi dy familjet që preken nga projekti i Unazës së Re dhe që po largohen nga shtëpitë e tyre, duke përfituar sipas ligjit



për banesat sociale ose me bonus qiraje. Kreu i qeverisë nuk nguroi të akuzojë kreun e demo-kratëve, Lulzim Basha, duke thënë se nuk ka lidhje me interesat e qytetarëve. Rama shkruan se këto familje po ndahen nga lukunia e SHQUP-it. Sipas kryeministrit ...  
Në faqen 2

## UNAZA E MADHE PROTESTA

Kryebashkiaku, banorëve: Jam shpellar më shumë se ju, por ejani të zgjidhim problemin

# Veliaj takon banorët e "Astirit", Rama: Ndahuni nga lukunia e SHQUP-it

*Kreu i bashkisë: Mund të rritim bonusin e qirasë*

Banesat sociale të Bashkisë së Tiranës në Shkollë priten dhe dy familjet e para që preken nga projekti i Unazës së Madhe. Kryeministri Edi Rama përgëzoi dhe familjet që preken nga projekti i Unazës së Re dhe që po largohen nga shtëpitë e tyre, duke përfutur sipas ligjit për banesat sociale ose me bonus qiraje. Kreu i qeverisë nuk nguroi të akuzojë kreun e demokratëve, Lulzim Basha, duke thënë se nuk ka lidhje me interesat e qytetarëve. Rama shkruan se këto familje po ndahen nga lukunia e SHQUP-it. Sipas kryeministrit, hesapet e Lulzim Bashës s'kanë lidhje me interesat e qytetarëve. "Përgëzime familjeve të Unazës së Re, që po ndahen nga lukunia e SHQUP-it dhe po përfutur sipas ligjit, banesën sociale, bonusin e qirasë trevjeçare apo lekët e shpronësimit për interes publik. Hesapet e Lul Kadriut s'kanë lidhje me interesat e tyre, të Tiranës e Shqipërisë që duam", theksoi z.Rama. Edhe kreu i Bashkisë së Tiranës, Erion Veliaj, ka bindjen se është koha që njerëzit të bëjnë logaritë e tyre dhe jo të SHQUP-it, që i ka mish për top. "Familjet e para që preken nga projekti Unazës janë banesat primitive pa leje mbi kolektorë në gjurmë të rrugës, për një fillim të ri me banesa dinjitoze sociale", shkruan Veliaj në "Twitter". Po dhe z.Veliaj takoi disa nga banorët e zonës së "Astirit", banesat e të cilëve do të shemben pasi kalon gjurma e projektit të Unazës së Madhe. Veliaj ftoi banorët të gjendet një rrugë e mesme, duke trajtuar rast pas rasti. "Të gjejmë gjuhën për të gjetur një të mesme. Lëshim nuk është vetëm territori, por edhe krenari e inate", u shpreh ai. Kryebashkiaku sqaroi dhe etiketimin "shpellarë". "Nga Tirana në Burrel shkohet për 2 orë. Nga Tirana në Tërpan, që është fshati i plakut tim duhet të shkosh një herë në Berat të bësh nga 3 orë të tjera rrugë dhish. Dmth., të shkosh tek shtë-



Kreu i bashkisë Erion Veliaj gjatë takimit të djeshëm me banorët e zonës së "Astirit"

### BONUSI

Z.Veliaj u premtoi banorëve që i kanë të regjistruara banesat e tyre se përveç shpronësimit, do t'u sigurohet edhe leje ndërtimi, nëse ata kanë tokë tjetër për të ndërtuar. "Bonusi i qirasë cash është 3 vjet, po edhe atë mund ta rrisim, po banesa sociale gjithë jetën", tha z.Veliaj.

## Çështja e Unazës së Re shkon në Bruksel

### Shembja e banesave, Mediu:

### Qeveria po dhunën jetën e qytetarëve

Kreu i Partisë Republikane, Fatmir Mediu, ishte dhe i pranishëm në takimin e nivelit të lartë në Parlamentin Evropian në Bruksel. Në këtë takim, Mediu përmendi se vendi është pa Gjykatë Kushtetuese dhe të gjithë pushtetin e ka kryeministri. "Një gjyqësor i kontrolluar politikisht është më i rrezikshëm se një gjyqësor i korruptuar. Së dyti, Shqipëria ka probleme të mëdha me zgjedhjet. S'kemi zgjedhje të lira. OSBE/ODHIR në raportin për zgjedhjet ka thek-



suar blerjen masive të zgjedhjeve. Hetimet e grupeve kriminale kanë provuar përgjime të grupeve kriminale me përfaqësues të qeverisë për blerje masive të

ata i ke në Holandë. E quaj një parti shpellare se përdor taktika të dhunshme, nuk tërhiqem. U shofshin të gjitha partitë që përcajnë njerëzit. Nuk kërkohet takimi duke djegur goma para bashkisë, sepse mesazhi që po jep është se çdo gjë bëhet me sherr", u shpreh z.Erion Veliaj. Ai bëri të ditur edhe një herë se për të gjithë ata që s'kanë mundësi ekonomike, Bashkia e Tiranës ka vendosur në dispozicion disa zgjidhje nga paketa e saj sociale,

votave. Kemi nevojë për mbështetjen e BE-së, për t'i dhënë fund vjedhjes së votave dhe vendosjen para drejtësisë të politikanëve që cenojnë zgjedhjet e lira dhe të ndershme. Së treti, prona private e ligjshme në Shqipëri nuk respektohet, nuk respektohen vendimet e Gjykatës së Strasburgut. Tensionin i krijuar nga qeveria nën pretekstin e investimeve, duke shkelur të drejtat e pronës, biznesit dhe jetës së qytetarëve siç është rasti i Unazës së Tiranës është i papranueshëm", tha Mediu.

duke filluar që nga bonusi i qirasë e deri te strehimi në banesa sociale. Z.Veliaj u premtoi banorëve që i kanë të regjistruara banesat e tyre se përveç shpronësimit, do t'u sigurohet edhe leje ndërtimi nëse ata kanë tokë tjetër për të ndërtuar. Veliaj i falënderoi banorët që pranuan t'i hapin rrugë zbatimit të projektit, që do ta kthejë edhe këtë segment të Unazës në një rrugë sipas të gjitha standardeve, duke çliruar në të njëjtën kohë edhe trafikun e makinave.



Protesta e banorëve të Unazës së Re

## Zgjedhjet, në janar opozita zgjedh kandidatët

Kryemadhi: Unaza e Re? Deputetët e PS-së të shkojnë te ata që kërkuar votat

Kryetarja e LSI-së, Monika Kryemadhi gjatë takimit me strukturat drejtuese të LSI së Tiranës, u bëri dhe

qytetarëve që të mbështesin protestuesit e Unazës së Re. Kryemadhi tha se këta banorë janë heronj të vërtetë, jo sepse ata dolën sot kundër Edi Ramës, por sepse janë bërë bashkë dhe po rezistojnë përballë dhunës dhe presionit qeveritar. "Të gjithë të mos ndalem, t'i bashkohemi protestës së banorëve të Unazës së Re. Të gjithë kemi nga një mik, nga një shok, nga një familjar që jetojnë atje. Janë njerëz si puna jonë, janë njerëz të cilët janë stërmunduar janë rrsakitur për të ndërtuar banesat e tyre, edhe bizneset, se nuk ka asnjë gjë të keqe, se nuk jemi në kohën e Partisë së Punës, që kush kish-te biznes ishte kulak. Jemi në demokraci, nëse ne diskutojmë sot edhe demokracinë, atëherë kot që rrimë këtu. Prandaj do t'ju bëj thirrje, kudo që jeni, çdo ditë, brenda mundësive, pa prishur programin tuaj, por ndonjëherë edhe duke e prishur programin dhe rutinën tonë, t'ju bashkohemi qytetarëve të Unazës së Re, banorëve të Unazës së Re, sepse ata janë heronj të vërtetë. Nuk janë heronj, sepse dolën sot kundër Edi Ramës, janë heronj sepse më shumë se 20 ditë kanë qëndruar të bashkuar; kanë qëndruar bashkë, ju kanë bërë ballëçdo presioni, çdo dhunë, çdo intimidim, çdo përçarje dhe kanë qenë një mësim i mirë për të gjithë. Sepse ne, nuk do të bashkohemi me ta, nesër do të jetë shumë vonë", tha Kryemadhi.



### KANDIDATËT

Kryemadhi foli edhe për marrëveshjen me PD, duke i kërkuar kryetarëve të degëve që të koordinohen me strukturat e partive opozitare, pasi në janar do të përcaktohen kandidatët e opozitës me të cilët do të dalë në zgjedhjet lokale.



Protestuesit përplasen me policinë për heqjen e ndriçuesve. ARRSH: Projekti i ligjshëm

# Banorët tek 'Astiri': Nuk na përçani dot! 'Jug, veri jemi një'

107 subjekte përjashtohen nga legalizimi

Valentina Madani

Banorët e Unazës së Re kundërshtuan sërish dje aksionin e IKMT-së për shembjen e banesave, dhe hapjen rrugë ndërtimit të Unazës së Madhe. Ata janë kundër projektit për ndërtimin e Unazës së Madhe, ndërsa edhe dje bllokuan rrugën "Teodor Keko" duke penguar kalimin e automjeteve në njërin sens. Shkak ishte vijimi i punës për heqjen e ndriçimit në zonë, prej të cilit banorët u konfliktuan edhe me policinë, e cila ishte pranë punonjësve të bashkisë. Ata mbajtën të bllokuar rrugën, siç kanë bërë për 24 ditë me radhë, ndërkohë që kanë kërkuar nga qeveria kompensim 100% të shtëpive të tyre. "Nuk na përçani dot", "Jug, veri jemi një" e "Do t'i mbrojmë shtëpitë me gjak", kanë qenë disa nga thirrjet e protestuesve. Në mbështetje të tyre ishin edhe deputetët e PD-së. Bllokimi i rrugës ndërpreu aksionin e IKMT-së, e cila e mbështetur nga policia bashkiake dhe e rendit, vijoi mëngjesin e sotëm shembjen e banesave që preken nga projekti i Unazës së Re dhe heqjen e shtyllave të ndriçimit. Banorët të kësaj zone thonë se askush nuk i ka pranuar banesat sociale dhe se ata që i kanë pranuar kanë pasur nga një kotec pulash në vend të shtëpisë. "Asnjë nga banorët nuk ka pranuar, show i Erjon Veliaj. Ka marrë dy familje që rrinë tek pularia dhe i ka cuar atje. Në ato kotecat le të shkojë të rrijë ai, unë jo. Do t'i përçajë", tha një banor.

**PROJEKTI**  
Drejtori i ARRSH, Afrim Qëndro u bëri thirrje banorëve të Astirit që të paraqiten pranë ARRSH me dokumentet e pronave të tyre. Po ashtu ai hodhi poshtë akuzat e opozitës, në lidhje me faktin se projekti në fjalë është i jashtëligjshëm. Sipas Qëndros, për projektin janë ndjekur të gjitha procedurat, ndërsa sqaroi të gjitha hapat dhe vendimet që u morën, para se të niste shembja e objekteve në këtë zonë. "U bëj thirrje banorëve të dorëzojnë të gjithë dokumentet që të nxjerrim VKM për të bërë të mundur shpronësimin. Ata që janë me legalizim, të bashkëpunojnë me ALUIZNI-n dhe me Bashkinë e Tiranës.



**BLOKIMI**  
Banorët e Astirit mbajtën të bllokuar rrugën, siç kanë bërë për 24 ditë me radhë, ndërkohë që kanë kërkuar nga qeveria kompensim 100% të shtëpive të tyre. "Nuk na përçani dot", "Jug, veri jemi një" e "Do t'i mbrojmë shtëpitë me gjak", kanë qenë disa nga thirrjet e protestuesve.

**SHKURTE**

**Banorët peticion Arta Markut: Ndërrpfit punimet në 'Astir'**

Banorët që preken nga projekti i Unazës së Madhe i kanë dërguar një peticion kryeprokurores Arta Marku, ku i shprehin asaj shqetësimin për vendimin që qeveria dhe bashkia kanë marrë, ndërsa i kërkojnë edhe ndërprerjen e punimeve. Po ashtu në peticion kërkojnë edhe lirimi i Dorian Protoduarit, Daniel Drobajt dhe 50-vjeçarit Ilias Sketiraj që qëllim me këpucë në drejtim të kryeministrit Edi Rama. Daniel Drobaj, u la në burg, pasi akuzohet se plagosi me kapsollë policen Ina Nuka. Banorët edhe dje kundërshtuan projektin për ndërtimin e Unazës së Madhe, duke bllokuar edhe rrugën.

**Tabaku: Unaza kushton 48 milionë euro, 24 milionë euro për kilometër**

Deputetja e Partisë Demokratike, Jorida Tabaku, publikoi dje shifra të reja lidhur me koston e Unazës së Re. Sipas saj ajo kushton 48 milionë euro dhe 24 milionë euro për kilometër. Ajo shprehet se ka ditë që opozita thotë se kostoja e Unazës së Tiranës është 20 milionë euro për kilometër, por, sipas saj, është edhe më shumë. Në një postim në Facebook, Tabaku publikoi tabelat me shpenzimeve të ndërtimit të rrugës. "Mbi koston e Unazës së Tiranës! Kemi disa ditë që diskutojmë për koston e Unazës së Tiranës dhe faktit që kosto për kilometër është 20 mln euro. Në fakt, të gjitha tenderët publikë japin vlerën e tenderit pa TVSH që do të thotë kosto është në të vërtetë 48 milionë euro dhe 24 milionë euro për kilometër. Tabela e ARRSH e tregon më së miri korrupsionin e paprecedent me këtë tender!", shprehet deputetja e PD-së.

**Paloka: Banorët e 'Astirit' kërcënohen natën nga kriminelët**

Nënkretarit i PD-së Edi Paloka i pranishëm dhe në protestën e banorëve të Unazës së Re, akuzoi se gjatë natës banorët e Astirit po kërcënohen nga kriminelë që vijnë në zonë me makina me xhama të zinj. "Ndërsa krimi bën nam. Një monstër që kemi kryeministër i pangopur bashkë me vëllin e bashkisë kërkojnë të fusin miliona të tjera në xhep. Këtu është krimi bashkë me Edi Ramën. Sot (dje) banorët më denoncuan një fakt tjetër. Çfarë ndodh ditën me policinë është histori tjetër me atë që ndodh natën. Natën vijnë kriminelë, kriminelë ordinerë që, siç duket, kanë marrë premtime për të ndërtuar pallate kur të largohen këta banorë. Vijnë dhe kërcënojnë banorët. Vijnë natën me xhama të zinj, me makina të maskuara dhe iu bëjnë presion banorëve, kriminelë ordinerë", deklaroi Paloka.

**Basha mesazh demokratëve: Na pret betejë e madhe, gati për "luftën" ndaj qeverisë**

Kreu demokrat, Lulzim Basha votoi dje për zgjedhjet e brendshme në PD të zyrat e partisë të degës nr. 8. Ai u shpreh i kënaqur me pjesëmarrjen e demokratëve në votim në mbarë vendin, ndërkohë që lajmëroi se opozita do të jetë gati për të luftuar kundër krimit në politikë. Kreu i PD u shpreh se partia e tij do të ofrojë një model të ri qeverisjeje, atë të vlerave dhe konkurrencës së lirë. "Siç e shikoni, shiu nuk i ka ndaluar qindra demokratë të degës nr. 8 në zemër të kryeqytetit të marrin pjesë në përfundimin e procesit zgjedhor në zgjedhjet për kryetarin e kësaj dege. Si anëtar i kësaj dege kam pasur privilegjin të hedh



votën e parë në këtë proces. Në të gjithë Shqipërinë për herë të parë me parim një anëtar një votë janë zgjedhur mbi 845 kryetarë grup-sekonesh dhe po zgjidhen me të njëjtin parim nga anëtarësia e degëve edhe kryetarët e degëve të PD. Kjo do t'i hapë rrugë Kuvendit Kombëtar të PD, zgjedhjes së Këshillit Kombëtar, dhe krijimit të shta-

beve elektorale dhe politike të Partisë Demokratike dhe të mbarë opozitës për betejën e madhe që na pret, betejë të cilën e kemi nisur duke ofruar një model të vlerave, të konfirmimit të vlerave, të luftës pa kompromis kundër infiltrimit të krimit në politikë dhe ofrimit të një modeli të ri, të një modeli të vlerave, të një modeli të energjive patriotike, të një modeli të konkurrencës së lirë, që nesër do t'ua ofrojmë shqiptarëve dhe Shqipërisë për t'i çliruar nga zgjedhja e krimit dhe korrupsionit. Ju uroj suksese kandidatëve dhe dua të shpreh vlerësimin për pjesëmarrjen maksimale në këtë proces votimi anëmbanë vendit", tha Basha.

Meqë kemi pasur disa akuzat nga eksponentët të opozitës dhe jo vetëm, dua të shpjegoj disa gjëra. Dua të shpjegoj se projekti i segmentit të Unazës i ka ndjekur të gjitha hapat ligjorë të duhur. Kemi një kërkesë zyrtare nga bashkia, nga ana tjetër miratimin e fondit nga Ministria e Transportit, më pas urdhrin e drejtorit të ARRSH dhe më pas Këshillin Teknik", tha Qëndro.

**ALUIZNI**  
ALUIZNI publikoi dje listën me 107 subjekte të cilëve iu ndërprerit procesi i legalizimit për objektet e ndërtaura në "Unazën e Re". Prej

dy muajsh ALUIZNI ka filluar një punë paraprake për evidentimin e objekteve pa leje që preken nga projekti i Unazës së Madhe. Sipas ALUIZNI-t kjo u bë mbi bazën e projektit paraprak të miratuar nga Këshilli Teknik i ARRSH-së për projektin "Rehabilitimi i segmentit rrugor mbikalimi i Pallatit me Shigjeta - rrethrotullimi "Shqiponja", Bashkia Tiranë". Mbi bazën e këtij projekti, drejtoritë e ALUIZNI-t Tiranë, vijuan procedurat e përjashtimit nga procesi i legalizimit të objekteve që prek ky projekt. Ditën e sotme ALUIZNI ka paraqitur listën e subjekteve që skualifikohen nga

procesi i legalizimit, për shkak të zbatimit të projektit të Unazës së Madhe. Nga ana tjetër, drejtoria e ALUIZNI-t sqaron se subjektet me leje legalizimi, subjektet me certifikatë pronësie të ligjshme, apo subjekte të tjera me pronësi të vjetër të certifikuar, nuk janë pjesë e kësaj liste, pasi ata janë përfshirë në listën e shpronësimeve për interes publik, që po harton ARRSH-ja. "ALUIZNI, së bashku me ZRPP, ARRSH dhe Bashkinë Tiranë, me grupet e tyre të përbashkëta të punës, mbeten në dispozicion të qytetarëve për çdo lloj sqarimi, verifikimi dhe plotësimi dokumentar".

## BOJKOTI APELI

Ambasadorja gjermane është shprehur se e djathta duhet të kthehet në parlament

# Gjermania dhe Austria, kundër bojkotit të opozitës: Beteja në Kuvend

"Shqipërisë i duhet kontributi parlamentar i pakicës"

Bashkimi European këmbëngul se vendi i opozitës duhet të jetë në Kuvend. Pas deklaratës së raportuesit për Shqipërinë në PE, Knut Flecknestein, edhe Gjermania është pozicionuar kundër bojkotit të opozitës si instrument i luftës politike. Ambasadorja e Gjermanisë në vendin tonë, Susanne Shutz duke folur nga Korça theksoi se vendi ka nevojë për një opozitë që të jetë në Kuvend. Madje, ajo nuk nguroi që t'i bëjë apel asaj që të kthehet në Kuvend për të diskutuar dhe të japë kontributin e saj në miratimin e disa ligjeve shumë të rëndësishme, që kërkojnë një shumicë të cilësuar votash. "Ne jemi të mendimit që në demokraci nevojitet një opozitë, por edhe për këtë opozitë vendi është në parlament dhe unë i bëj apel opozitës që të kthehet përsëri në parlament, sepse ka shumë ligje për t'u miratuar si reforma e Kodit Zgjedhor, për të cilat nevojitet edhe vota e opozitës", - u shpreh ajo. Deklarata e ambasadores gjermane erdhi në të njëjtën ditë me qëndrimin që mbajti dje në Tiranë edhe një nga përfaqësuesit e lartë austriak, Wolfgang Sobotka, President i Këshillit Kombëtar të Austrisë. I gjendur në Tiranë në kuadër të një vizite zyrtare, gjatë një takimi me kryetarin e Kuvendit Gramoz Ruçi, ai u shpreh në të njëjtën linjë me qëndrimin e shprehur tashmë edhe nga Bashkimi European, se opozita duhet të heqë dorë nga bojkoti dhe se beteja politike duhet të zhvillohet në sallën e parlamentit. Duke u ndalur te situata politike në Shqipëri, presidenti Sobotka u shpreh se procesi integruar i Shqipërisë ka nevojë si për rolin e qeverisë, ashtu edhe për atë të opozitës parlamentare. "Shqipëria ende ka nevojë si për dorën e shtrirë të qeverisë, ashtu edhe për kontributin parlamentar të opozitës. Opozita e ka vendin në parlament", u shpreh Sobotka. Ai shtoi se duke u nisur nga historia ballkanike, Europa nxit përpjekjet e vendeve të rajonit për kalimin nga konfliktet në ndërtimin e partneriteteve për zhvillim. "Fati i ballkanasve është më shumë në dorë të tyre. Austria mbështet nxitjen e kontributit të të rinjve e të vendeve të Ballkanit, në procesin e bashkëpunimit dhe të mirëkuptimit midis këtyre vendeve. Një Ballkan i sigurt dhe i zhvilluar, do të thotë një Europë e sigurt dhe e zhvilluar. Unë do t'ju jepja dy këshilla: bëni kujdes me vendet skeptike për Shqipërinë, në



Ambasadorja e Gjermanisë në vendin tonë, Susanne Shutz

## Bashkimi i Shqipërisë me Serbinë, Brukseli i kërkon shpjegime Ballës

Deklaratat kryeministrit të Shqipërisë, Edi Rama, mbajtur gjatë mbledhjes së përbashkët të qeverive në Pejë janë bërë objekt debati në mbledhjen e eurodeputetëve në Bruksel. Kështu, eurodeputeti qipriot Takis Hadjigeorgiou, duke përfutur edhe nga prania e një përfaqësuesi të parlamentit shqiptar, ka lexuar fjalën që mbajti Rama, duke deklaruar se kryeministri foli për "bashkimin Shqipëri Kosovë në 2025" dhe "qëndrimin me dy fytyra të Serbisë". Për këtë gjë, ai kërkoi shpjegime nga deputeti Taulant Balla. "Dua nga zoti Taulant Balla shpjegime", - tha në mblyllje të fjalës së tij eurodeputeti qipriot. Por nga ana e tij, kreu i grupit parlamentar socialist u shpreh se në këto deklarata nuk ka asgjë për t'u shqetësuar dhe se bëhet fjalë vetëm për bashkëpunim në kuadër të procesit integruar në BE. "Ne besojmë se 2025 është momenti anëtarësimit të vendeve të Ballkanit Perëndimor në Bashkimin European. Mos kini frikë nga bashkëpunimi mes shqiptarëve. Jemi faktor i rëndësishëm stabiliteti dhe paqesje në Ballkan. Jemi krenarë që jemi kombi me proeuropian në rajon. Serbia duhet të çlirohet nga kompleksët e vjetra ballkanike dhe duhet të pranojë realitetin e ri të pakthyesëm dhe të njohë pavarësinë e Kosovës", tha Balla. Ndërkohë që ai i ka kujtuar eurodeputetit qipriot praninë e koleges së tij, Eleni Theocharous, në ceremoninë e varrimit të Kostandinos Kacifas në Bularat. "Nuk e di se pse një eurodeputete qipriote (Eleni Theocharous) duhet të marrë pjesë në ceremoninë e varrimit të një personi që qëlloi mbi policinë. Kudo në Europë të qëllosh mbi policinë është akt terrorist. Janë të papranueshme për normat dhe vlerat e këtij parlamenti qëndrime dhe deklarata të tilla", tha Balla.

mënyrë që ato të qartësohen për arritjet tuaja dhe përpikuni që Ballkani të shndërrohet në një hapësirë ekonomike e unifikuar, duke hequr barrierat midis jush, si ballkanas, nënvizoi presidenti i Këshillit Kombëtar të Austrisë, Wolfgang Sobotka. Qëndrimet kundër bojkotit të opozitës kanë ardhur duke u shtuar

ditët e fundit nga përfaqësues të lartë të BE-së, ndërsa kanë theksuar me forcë se vendi i debatit politik duhet të jetë parlamenti. "Unë personalisht mendoj që beteja kryesore duhet të bëhet brenda parlamentit. Kjo është çështje parimi dhe jo për të thënë se cila ka të drejtë cila jo", u shpreh para pak javësh Knut Flecknestein.

### SHUTZ

"Ne jemi të mendimit që në demokraci nevojitet një opozitë, por edhe për këtë opozitë, vendi është në parlament dhe unë i bëj apel asaj që të kthehet përsëri në parlament, sepse ka shumë ligje për t'u miratuar si reforma e Kodit Zgjedhor, për të cilat nevojitet edhe vota e opozitës", - u shpreh ajo.

## Presidenti dekoron ish-ambasadorin amerikan

# Takimet me Metën dhe Ruçin, Arvizu: Vendi i opozitës, në Kuvend

Në një ceremoni solemne, Presidenti Ilir Meta vlerësoi dje z. Aleksandër Arvizu me titullin "Për Merita të Veçanta Civile". Kreu i shtetit shqiptar i akordoi ish-ambasadorit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës titullin e lartë me motivacionin: "Në vlerësim të veprimtarisë diplomatike dhe kontributit të tij të çmuar në përpunimin e gjithanshëm të marrëdhënieve dypalëshe gjatë mandatit të tij si ambasador i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, por edhe në vijim si dhe për mbështetjen e pakursyer të procesit të integritimit euro-atlantik të vendit". "Arvizu ka një meritë të veçantë për mbështetjen e pakursyer të procesit të integritimit euroatlantik të vendit si dhe për ndihmën efikase në përpunimin e reformave kyçe, përfshirë luftën kundër krimit të organizuar,



por edhe reformën në drejtësi. Për reformën në drejtësi, që ka qenë kryefjala e viteve të fundit, do të theksoja në veçanti angazhimin e tij jo shumë të dukshëm, por mjaft aktiv në detyrën e zvendhës Sekretarit të Shtetit për çështjet e drejtësisë dhe të luftës kundër drogës", tha z. Meta. Ish-ambasadori amerikan në Tiranë, Aleksandër Arvizu takoi dje edhe kreun e Kuvendit të Shqipërisë, Gramoz Ruçin, me të cilin diskutoi

rreth situatës politike në vend, ku midis të tjerave ishte edhe bojkoti i opozitës. Ish-ambasadori theksoi se vendi i opozitës është në Kuvend dhe se me beteja e saj politike dhe parlamentare, duhet t'u japë shqiptarëve arsye dhe motive për ta votuar atë. "Vendi i opozitës është në Kuvend dhe me prezencën dhe beteja e saj politike e parlamentare, ajo duhet t'u japë shqiptarëve dhe mbështetësve të saj arsye dhe motive për ta votuar. Shqiptarët nuk duhet të humbasin shpresën dhe besimin te vetja e tyre se Shqipëria mund të bëhet. Ata vetë duhet të kontribuojnë për ndryshimin si edhe për përbalimin e problemeve që ka vendi, si korrupsioni, lufta kundër krimit të organizuar etj. Vetë Shqipëria është një vend dhe një partner i besueshëm", - u shpreh Arvizu.

## Propozimi i Ilir Metës për KLSH, Vitore Tusha para Komisionit të Ekonomisë

Në mbledhjen e djeshme të Komisionit të Ekonomisë u shqyrtua dekreti i Presidentit Ilir Meta për propozimin e kreu të ri të Kontrollit të Lartë të Shtetit. Në seancë mori pjesë edhe kandidatja e propozuar nga Meta, Vitore Tusha, anëtare e Gjykatës Kushtetuese. Gjatë fjalës së saj, Tusha pohoi se e ndjen përgjegjësi që presidenti i propozoi në kreun e KLSH-së. "Përgjegjësi për mua, propozimi i presidentit. Drejtimi i KLSH-së të jetë sipas frymës së vendeve të përpunuara. KLSH-ja duhet të ketë cilësinë e caktuar të institucionit si i pavarur: Komunikimi me parlamentin është

të shumë i rëndësishëm", - është shprehur Tusha. Për këtë pozicion ishin 34 emra në garë, mes tyre edhe figura të politikës dhe botës akademike, por Meta arriti në konkurrencë se Tusha plotëson kushtet dhe kriteret ligjore, si kandidatura më e përshtatshme për t'u zgjedhur në këtë pozicion kushtetues, bazuar në eksperiencën solide dhe kontributin e pandërprerë. Kujtojmë se kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit ka mandat 7-vjeçar që votohet në Kuvend, ndërsa aktualisht ky post drejtohet nga Bujar Leskaj. Mandati i këtij të fundit mbaron në dhjetor të 2018-ës.



Kryeministri Edi Rama dhe në Samitin e Investimeve në Turizëm



Samiti, kryeministri Rama kërkon projekte ambicioze për turizmin në Shqipëri

# Klosi vlerëson "Prestige Resort". Arkitekti: Vitin tjetër, park ujq

*Xhexhi: Projekt efektiv me pritshmëri të mëdha*

Në Tiranë u mbajt Samiti i Investimeve në Turizëm ku ndër të tjera "Prestige Resort" u vlerësua si një nga investimet model të kësaj fushe. Në fjalën e tij në këtë takim kryeministri Edi Rama kërkoj projekte ambicioze për turizmin në Shqipëri, ndërsa bëri të ditur se këtë vit Shqipëria përjetoi sezonin më të mirë turistik jo vetëm për numrin e turistëve, por dhe të ardhurat dhe rritje të punësimit. Ai theksoi se Shqipëria është në fazën e realizimit të një kapërcimi të madh mes një turizmi të inercisë, një turizmi të ndërtuar mbi atë çfarë na ka dhënë Zoti, nga nisma kaotike te sipërmarrje me vizion afatgjatë. "Në 2017 janë dhënë leje për ndërtim hotelesh më shumë se sa në 4 vite të mëparshme të marra së bashku dhe sipërfaqja totale e metrave katrorë hoteleri që do të krijohet nga lejet e dhëna në 2017 është një sipërfaqe më e madhe se sa sipërfaqja e ndërtuar për hotele në 10 vite më parë. Vitin e ardhshëm do të kemi 5-fishim të kërkesave. Të dhënat e INSTAT flasin për një rritje edhe më të madhe në 2018", deklaroi kryeministri. Ai, gjithashtu, bëri të ditur se termi fshat turistik do fshihet nga fjalori dhe se nuk do të jepen më leje për organizime turistike që pas një kohe të caktuar kthehen në lagje banimi.



**PROJEKTI**

"Historia e 'Prestige Resort' nis në vitin 2004 në Golem dhe zhvillimi vijon. Zona e 'Prestige Resort' është shumë e madhe dhe në bashkëpunim me 'Apollo' kemi një projekt shumë efektiv nga i cili do kemi pritshmëri të mëdha. Projekti 'Aqua park', me kapacitet 1 mijë njerëz pritet të përfundojë vitin tjetër. Po bashkëpunojmë me firmat turke për parkun ujq 'Aqua park'. Turistët e huaj e gjejnë veten dhe ndihen shumë mirë në resortin tonë"- tha Xhexhi.

**Braçe do e propozojë edhe në seancë plenare**

## S'ka konsensus, nuk hiqet tatimi për pagat deri në 40 mijë lekë

Deputetët socialistë në Komisionin parlamentar të Ekonomisë dhe Financave nuk kanë gjetur dakortësinë për të votuar propozimin për të rritur nga 30 mijë lekë në 40 mijë lekë fashën e pagave të patatueshme. Komisioni ka miratuar projektbuxhetin e vitit 2019 dhe paketën fiskale, por nuk ka marrë në konsideratë propozimin që u bë gjatë shqyrtimit në parim. Në fakt, mbledhja e djeshme është shoqëruar me një sërë parregullsish, të karakterit organizativ dhe procedural. Kështu në kundërshtim me rregullat parlamentare ajo është drejtuar nga sekretari i komisionit, Anastas Angjeli. Kjo pasi kryetari i komisionit, Erion Braçe nuk ka qenë i pranishëm në nisje të mbledhjes dhe



drejtimin e saj e ka marrë Angjeli. Burime nga komisioni kanë bërë të ditur se shkak për mospraninë e Braçes në nisje të mbledhjes ka qenë pikërisht mosqetja e një pikësesusi mes deputetëve për të votuar ndry-

shimin e fashës së pagave të patatueshme nga 30 në 40 mijë lekë. Kështu, mësohet se deputetët socialistë të komisionit nuk e kanë mbështetur Braçen për ta konkretizuar këtë nisje, ndërsa kanë mbështetur qëndrimin e Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave që kjo fashë të mbetet 30 mijë lekë. Braçe ka mbërritur në mbledhje vetëm në mes të saj, teksa komisioni ishte në proces votimi. Ndërkohë që i pyetur nga "Gazeta Shqiptare" për këtë amendament, Braçe bëri të ditur se ai propozimin e tij do paraqiste në seancë plenare në mënyrë nominale. Gjatë mbledhjes së djeshme, Komisioni i Ekonomisë mori parasysh disa nga propozimet e bëra nga grupet e interesit dhe kryesisht nga biznesi.



## Tabaku: Kushtetuta si leckë, buxheti i shtetit u miratua në shkelje

Deputetja e Partisë Demokratike Jorida Tabaku e ka cilësuar të paligjshme mbledhjen e djeshme të Komisionit të Ekonomisë ku u votua nën për nen projektbuxheti i vitit 2019 dhe paketa fiskale që e shoqëron atë. Përmes një reagoni në rrjetet sociale Tabaku theksoi se buxheti i vitit 2019 u miratua në shkelje të rregullores, ndërsa mbledhja drejtohej nga sekretari i Komisionit. Sipas saj, qeveria në këtë rast ka shkelur Kushtetutën dhe çdo rregullorë. "Sot Komisioni i Ekonomisë ka miratuar dokumentin më të rëndësishëm të shtetit në shkelje të ligjit dhe rregullores së parlamentit. Sot mbledhja e komisionit është drejtuar nga sekretari i komisionit. Dy janë dokumentet më të rëndësishme të një qeverie programi dhe buxheti i shtetit. Kur buxheti i shtetit miratohet në shkelje të ligjit e të rregullores a ka më moral të qëndrojë një qeveri. Këta që shkelin Kushtetutën, çdo ligj, këto që e kanë bërë leckë çdo VKM, sot kanë shkelur me të dy këmbët dhe vetë parlamentin. A ka më vend për opozitën në këto institucione? Ministri i Financave i pari dhe i dyti kryeministri sot kanë shkelur parlamentin me të dy këmbët për një nga dy dokumentet më të rëndësishme të një qeverie!", shkroi Tabaku.

**DOKUMENTI**  
Komisioni i Ekonomisë ka miratuar dokumentin më të rëndësishëm të shtetit në shkelje të ligjit dhe rregullores së parlamentit. Sot mbledhja e komisionit është drejtuar nga sekretari i komisionit.

Gjatë fjalës së tij në këtë takim, ministri i Turizmit dhe Mjedisit Blendi Klosi u shpreh se po investohet nga veriu në jug në fushën e turizmit. Ministri tha se 10 marka të njohura zgjodhën të investojnë në Shqipëri, ndërsa përmendi me edhe 'Prestige Resort' si një nga kompanitë që ka investuar në turizëm dhe ofron shërbimin më të mirë. "10 marka ndërkombëtare zgjodhën të investojnë në Shqipëri. Prestige, Royal, Prince, janë dhjetëra kompani me qindra dhoma në bregdetin shqiptar që presin turistët në Shqipëri me shërbimin e tyre. 115 hotele kanë marrë leje në 6-mujorin e parë. Nuk kemi mbledhur sot këtu vetëm për t'i thënë çdo sipërmarrësi vendas dhe ndërkombëtar se këni bërë investimin e duhur, por mbi të gjitha jemi këtu për të mar-

rë përgjegjësinë e këtij zhvillimi të vullshëm", - u shpreh ministri Klosi në fjalën e tij. Ai theksoi se sfida për qeverinë dhe vendin tonë mbetet ardhja e 10 milionë turistëve në një vit. "Modeli pa model për të gëzuar fitimi të menjëhershëm është ezauruar dhe sfida jonë e sotme është 10 milionë turistë brenda një viti. Qeveria ka bërë ndërhyrje në sektorët jetikë. Sfi- da 10 milionë turistë është puna jonë. Nuk duhet të lejojmë investime pa model. Sot propozojmë modelin e

qartë me 5 pika. Kemi përcaktuar 6 destinacione nga veriu në jug", tha Klosi.  
**PARKU UJOR**  
Arkitekti i kompanisë 'Hysbelliu Group', Klodian Xhexhi tregoi historinë e suksesit të "Prestige Resort" në Golem si dhe bashkëpunimin me 'Apollo' për ndërtimin e parkut ujq 'Aqua park'. Xhexhi u shpreh se turistët nga vendi, por edhe nga vendet e ndryshme të botës mbeten të kënaqur me shërbimin dhe investimin e "Prestige Re-

sort". "Historia e 'Prestige Resort' nis në vitin 2004 në Golem dhe zhvillimi vijon. Zona e 'Prestige Resort' është shumë e madhe dhe në bashkëpunim me 'Apollo' kemi një projekt shumë efektiv nga i cili do kemi pritshmëri të mëdha. Projekti 'Aqua park', me kapacitet 1 mijë njerëz pritet të përfundojë vitin tjetër. Po bashkëpunojmë me firmat turke për parkun ujq 'Aqua park'. Turistët e huaj e gjejnë veten dhe ndihen shumë mirë në resortin tonë"- tha Xhexhi.

Ndryshoi veprën penale një të dënuari për vrasje kundrejt 30 mijë eurove

# Korrupsioni, dënohet me 2.6 vite burg ish-gjyqtari i Apelit, Shkëlqim Miri

TIRANË

Gjykata e Krimeve të Rënda ka dënuar me 2 vite e 6 muaj burg, ish-gjyqtarin e Apelit të Tiranës, Shkëlqim Miri, i cili është akuzuar për korrupsion. Ai u shpall fajtor, pasi i ndryshoi veprën penale një të dënuari për vrasje kundrejt rryshfetit. Prokuroria për Krime të Rënda kërkoi dënimin me 4 vite heqje lirie për ish-gjyqtarin në fjalë, por gjykata pranoi gjykimin e shkurtuar duke e dënuar në total me 2.6 vite burg. Ish-gjyqtari i Gjykatës së Apelit Tiranë, Shkëlqim Miri, u arrestua më 10 nëntor të vitit të kaluar nën akuzat për korrupsion. Ndaj tij rëndon akuzat se ka marrë rryshfet 30 mijë euro në këmbim të një vendimi më të favorshëm ndaj Gentian Dodës i akuzuar për vrasje në vitin 1997. Nga kontrolli i ushtruar në banesën e tij, policia gjeti rreth 300 milionë lekë të vjetra. Për këtë shumë ish-gjyqtari Miri ishte shprehur se ishin para të një mikut të tij që do të blinte një pronë në Tiranë, ndërsa pjesa tjetër qëndri kursime nga paga. Shkëlqim Miri kërkoi lirinë në Gjykatën e Apelit, por kërkesa e tij u refuzua. Ish-



Ish-gjyqtari i Apelit, Shkëlqim Miri

gjyqtari ka qenë anëtar i KLD-së deri në vitin 2012-të dhe më herët gjyqtar i Apelit në Durrës (para 2010-ës). Ndër çështjet e bujshme që ka gjykuar Miri, është edhe ajo e Gërdecit, ku ai ka qenë pjesë e një prej proceseve gjyqësore. Ndërkaq, gjykata ka dënuar me 1 vit e 8 muaj burg kushëririn e gjyqtarit Miri, Kujtim Miri, i cili sipas prokurorisë kishte rolin e sekserit në aktin korruptiv. **I DËNUARI GENTIAN DODA** Prokuroria e Matit ka

kërkuar dënimin me 20 vjet burgim për Gentian Doda, i ekstraduar nga SHBA në 2012-ën, i akuzuar për vrasjen e Gazmir Dedja dhe Asllan Gjoka, ngjarje e ndodhur në tetor të vitit 1997. Autori Gentian Doda dhe viktimat Gazmir Dedja kanë qenë anëtarë të grupeve rivale në Burrel, konfliktin ndërmjet të cilëve ka vijuar për shumë vite dhe me shumë viktimat. Përplasjet e ashpra ndërmjet të grupeve rivale janë shtrirë edhe në qytete të tjera. Në vitin

2010, në Tiranë është vrarë edhe vëllai i viktimës, Halil Dedja, i cili u gjet i vdekur në hyrje të pallatit ku banonte. Ditën e ngjarjes së vitit 1997, autori Gentian Doda dhe viktimat Gazmir Dedja janë konfliktuar verbalisht dhe më pas, i pandehuri e ka qëlluar me automatik, duke e plagosur rëndë. Nga plumbat ka mbetur i vdekur aksidentalisht Asllan Gjoka. I plagosuri ka mundur të mbijetojë vetëm dy ditë për shkak të plagëve të marra, por ka arritur t'u tregojë familjarëve se kush e kishte qëlluar, duke identifikuar Gentian Dodën. Menjëherë pas krimit, i pandehuri është larguar jashtë Shqipërisë dhe është arrestuar në vitin 2012 në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, në zbatim të urdhër-arrestit ndërkombëtar të lëshuar nga autoritetet shqiptare. Pas ekstradimit, i akuzuari kërkoi rivendosi në afat dhe rishikim të dënimin të dhënë më parë ndaj tij për këtë veprë penale.



## 'Xhisiela', gjykata pranohet gjykim të shkurtuar për djalin e deputetit Rraja

TIRANË - Gjykata e Krujës ka pranuar kërkesën për gjykim të shkurtuar nga djali i deputetit të PS-së, Rexhep Rraja, ndërsa seanca gjyqësore e radhës është caktuar të zhvillohet më 4 dhjetor. Me pranimin e kërkesës për gjykim të shkurtuar në rast dënimi nga trupi gjyqësor, djali i deputetit socialist do përfitojë ulje dënimi me 1/3. Në seancën e djeshme ku u pranua edhe gjykimin e shkurtuar ishte e prishme dhe Xhisiela Maloku, e cila në këtë proces ka statusin e të dëmtuarës. Gjatë fjalës së saj, 25-vjeçrja ka deklaruar para gjyqtarëve Engjëllushë Tahiri se ka gënjyer për të gjithë kallëzimin e saj. Djali i deputetit Rrahman Rraja, Rexhep Rraja u arrestua më 30 shtator, pas urdhrin të Gjykatës së Krujës, e cila vendosi masën e sigurisë 'Arrest me burg', në mungesë për të riun e akuzuar për 'përndjekjen' e ish-të dashurës së tij, Xhisiela Malokut. Më herët avokati mbrojtës i Rrajës ka thënë se denoncimi nga Xhisiela Maloku është bërë për motive xhelozie dhe se nuk ka të bëjë fare me përndjekje. Çështja 'Xhisiela' krijoi debatë të forta politike, pasi opozita akuzoi deputetin Rrahman Rraja dhe deputetë të PS-së se i bënë presion policisë së Fushë-Krujës për ta mbyllur këtë dosje. Për këto akuzat prokuroria e Tiranës ka nisur një procedim të veçantë. Nga ana tjetër, ish-officeri i policisë gjyqësore në Fushë-Krujë Emiljano Nuhu pasi u dërgoi një letër autoriteteve më të larta në vend duke denoncuar rastin në fjalë kërkoi azil politik në Zvicër. Deri më tani, Nuhu nuk ka paraqitur as edhe një provë për të mbështetur pretendimet e ndërhyrjes së deputetëve socialistë në pengimin e hetimeve.

## Polonia ndihmë direkte për të prekurit nga përmbytjet e dy viteve të fundit në Shqipëri

Ndoshta nuk përmendet prej modestisë, por Caritas-i polak është një nga strukturat më afër me problematikën shqiptare. Dhe, nuk është habi që kohë e fundit Caritas-i polak (Caritas Poland) ka destinuar 110.000 euro, të mbledhura nga dhurimet speciale të polakëve në ndihmë të të prekurit nga përmbytjet e dy viteve të fundit në Shqipëri. Kjo ndihmë është, veç të tjerash, përgjigje e angazhimeve të qeverisë polake gjatë vizitës zyrtare të kryeministrit të Shqipërisë, Edi Rama, në Varshavë më 6 dhjetor 2017. Ndihma e Caritas-it polak mbërriti të 130 familje shqiptare. Projekti i ndihmës polake ka qenë i ndarë në dy etapa. Etapa e parë u përbush në rajonin e Shkodrës, ku u ndihmuan familjet të prekur nga fatkeqësitë natyrore në formën e materialeve të ndërtimit për të riparuar shtëpitë e përmbytura. Ndihma u materializua mes të tjerash në formën e blerjes së materialeve të ndërtimit, mobiljeve dhe artikujve të përdorimit bazë. Etapë



tjetër e ndihmës ka qenë blerja e pajisjeve elektroshtëpiake (pjesërisht të prodhuara në Poloni) për familje nga zona e Kamzës, të cilat kanë vuajtur pasojat e përmbytjeve. Për familjet në këtë zonë u dhuruan 70 frigoriferë, 75 lavatrice, 20 soba elektrike dhe me gaz, kaloriferë, hekurat etj. Artikujt me etiketën Caritas Polska u dhuruan familjeve në nevojë. Listen e nevojave e patën përgatitur me kohë priftërinjtë polakë me mision në Shqipëri, në bashkëpunim me Caritas-in shqiptar. Në ceremoninë e dorëzimit

të ndihmës ishin të pranishëm kryetari i Bashkisë Kamëz, Xhelal Mziu, përfaqësues të tjerë të pushtetit vendor, përfaqësues të Caritas Albania, Famullitari i kishës Shën Gjon Pali II në Bathore, Ati Andrezj Michon si dhe ambasadori i Republikës së Polonisë në Tiranë, Karol Bachura. Dorëzimi i ndihmës nga Caritas Poland koïncidon me momentin e bukur të festës së Pavarësisë së Shqipërisë, 28 Nëntor por edhe me afirmimin e festave të fundvitit, rast, pra i mirë, për të festuar dhe qenë me shpirt pranë njerëzve në nevojë.

### TENDER OPPORTUNITY FOR DUTY FREE BUSINESS at TIRANA INTERNATIONAL AIRPORT SHPK (TIA)

Tirana International Airport (TIA) would like to inform the interested parties about the following tender opportunity at the Terminal Building, Departure Area. The airport is a transportation hub for Albania and it represents a unique and highly attractive location for all retailers and caterers with a double digit growth in passengers.

**DUTY FREE**  
• Approx. 282 m<sup>2</sup>;

**Prospective tenants are expected to meet the following requirements:**

- Qualification and Experience with the object "Duty Free Management" (interested parties must provide examples / references); Information must be provided on similar current activities, number, size and location of outlets, years of operation, annual turnover in the last three years (or from the date of operation), total number of employees;
- Financial solidity, excellent standing and capability of the company; minimum relevant turnover in the last financial year of EUR 1,000,000 in the relevant field (interested parties must provide Profit & Loss statement of last three years);
- Relevant software/IT and data management experience concerning the Duty Free system used in the duty free areas managed by the company (interested parties must provide examples / references);
- To participate in this process interested parties will need to retrieve the Request for Proposal and sign the Confidentiality Commitment Document, which can be retrieved at Tirana International Airport, Administration Building, Rinas;
- Only to the companies that will submit the confidentiality commitment will be given the respective set of tender documents that contain the full information for submission of the proposals;
- The Request for Proposal will be distributed only on 07 December 2018 up to 14:00 Eastern Time, which, documents will be delivered in a CD, free of charge.

All inquiries and the Expression of Interest shall be addressed by hand or to all the following email address not later than 07 December 2018 up to 14:00 Eastern Time:

**Tirana International Airport N'n' Tereza SH.PK**  
Administration Building  
Commercial & Property Department  
Rinas, Albania

Emails:  
Commercial Department  
Legal Department  
Procurement Department

Alisa Gjinari  
lir.alimema  
Albi Palushi

aginari@tirana-airport.com  
ialimema@tirana-airport.com  
apalushi@tirana-airport.com

Zbardhet dëshmia e plotë, gjykata liron 45-vjeçarin 2 ditë pasi u vetëdorëzua

# Vrasja në ish-Blok, biznesmeni Ajaks Boshnjaku: Ja si nisi sherri në lokalin e Redi Popeskut

## Viktima iu drejtua Mevjol Bilos duke i thënë: "O pi... motre pse shikon"

TIRANË

Ajaks Boshnjaku, i cili u vetëdorëzua të dielën në Drejtorinë e Policisë së Tiranës për vrasjen në zonën e ish-Blokut, ngjarje kjo e ndodhur më 4 tetor të këtij viti ka deklaruar para prokurorëve të çështjes se nuk e dinte se ishte shpallur në kërkim. Ai është shprehur se sapo e ka mësuar një gjë të tillë, ka vendosur të vetëdorëzohet. Biznesmeni 45-vjeçar ka treguar me detaje se si nisi sherri mes grupit të Ervis Martinajt dhe atij të Ervin Matës në lokalin "Monopol" në pronësi të Redi Popeskut. Sipas tij, gjithçka ka nisur pas një sharje që i është bërë Mevjol Bilos nga viktima Fabian Gaxha. Po sipas Boshnjakut, sherri që më pas përfundoi me një të vranë dhe dy të plagosur ka nisur në një kohë kur Ervis Martinajt dhe Ervin Mata, pasi ishin takuar në lokal për shkak se kishin njohe të mëparshme dhe ishin ulur pranë banakut e po konsumonin nga një gotë verë. Ndërkaq, Gjikata e Tiranës ka vendosur ndaj 45-vjeçarit masën e sigurisë "Detyrim paraqitje", ndërsa në dëshminë e tij, ai ka thënë se nuk ka dijeni për motvet apo rrethanat e vrasjes. Masa për biznesmenin Boshnjakun është dhënë në një seancë gjyqësore që u zhvillua me dyer të mbyllura. Mësohet se prokuroria ka kërkuar lënien në fuqi të masës "Arrest me burg" dhënë në mungesë, ndërsa kishte ngritur ndaj tij akuzën e vrasjes së mbetur në tentativë.




Ajaks Boshnjaku

### NGJARJA NË ISH-BLOK

Mbrëmjen e 4 tetorit, pas një konflikti me armë në një lokal në Blok, mbeti i vranë 28-vjeçari Fabian Gaxha dhe u plagosën Ervis Martinajt dhe Elion Hate. Në kërkim për këtë ngjarje janë shpallur Mevjol Bilo, Ervin Mata dhe Fabiol Alushi. Gjatë dëshmisë Boshnjaku ka deklaruar se ka qenë në lokal në fillim të sherrit dhe sa ka filluar përleshja ka dalë dhe është larguar menjëherë prej ambienteve të lokalit "Monopol". Gjithashtu, ai njihet si mik i Ervin Matës, ku ky i fundit është njëherësh edhe partneri i këngëtares shqiptare Elvana Gjata.

### VIKTIMA DHE MEVJOL BILO

Teksa po bënim muhabet mes miqsh në këtë moment kanë ardhur 3-4 persona, të cilët i shoqëronte Redi Popesku dhe ndërkohë është ngritur Ervin Mata dhe i ka takuar normalisht dhe janë ulur në ambientet e banakut. Pasi janë ulur, njëri prej personave (siç më rezultoi mua personi që u vra) i është drejtuar shtetasit Mevjol Bilo duke i thënë "o pi... motre pse shikon", ndërsa Mevjol Bilo nuk ka folur fare. Ndërkohë, ky personi me pistoletë në dorë është drejtuar tek Mevjol Bilo duke i vënë pistoletën në kokë dhe më dorën tjetër e godiste me grushte në kokë dhe në fytyrë. Në të gjithë që ishim prezent nuk arritëm të lëviznim, pasi personi ishte me armë në dorë dhe thërriste që të mos lëviznim. Në këtë kohë Ervin Mata ka thirrur "Mos çfarë po bën", por personat filluan të godisnin më pas me grushte edhe Ervin Matën. Në goditje e sipër kam parë të rrezohet në tokë shtetasin Mevjol Bilo. Nuk arrita ta dalloj nga erdhja e shtëna me armë. Në këtë kohë kam ikur me vrap drejt derës për t'u larguar. Nuk e di më pas si vazhdoi konflikti në lokal. Kam marrë motorin dhe jam larguar në banesën time", -ka thënë Boshnjaku në dëshminë e tij.



Faksimile e dëshmisë së dhënë në Prokurori nga Boshnjaku

### Masakra te "Monopol", këngëtarja Elvana Gjata jo në kërkim policor

TIRANË - Afro dy muaj nga ngjarja e rëndë në ish-Blok, këngëtarja e njohur shqiptare Elvana Gjata nuk është më në kërkim policor. Mësohet se ka përfunduar afati prej 30 ditësh ku Gjata ishte në kërkim në lidhje me vrasjen në ish-Blok. Burime për "GSH" bënë me dije se njoftimi për Gjatën është dërguar në të gjitha pikat kufitare dhe nëse këngëtarja paraqitet aty, ajo do të shoqërohet për t'u marrë në pyetje. Ajo u shpall në kërkim më 9 tetor, ndërsa prokuroria urdhëroi shoqërimin e detyrueshëm të këngëtares, e cila ishte në lokalin ku ndodhi ngjarja vetëm 20 minuta para kërimit. Shpallja në kërkim policor e detyronte Gjatën që të paraqitej për të dhënë shpjegime brenda 30 ditëve, pasi duhej të jepte deklaratimet e saj për ngjarjen. Por kjo gjë nuk ka ndodhur.

## I dyshuar për ngjarjen e 4 tetorit, gjykata e Tiranës liron Geldo Hotin

TIRANË - Gjykata e Tiranës ka liruar nga masa e arrestit Geldo Hotin, i dyshuar si një nga autorët e masakrës së ndodhur mbrëmjen e 4 tetorit në zonën e ish-Blokut, ku mbeti i vranë Fabian Gaxha dhe u plagosën Ervis Martinajt dhe Elion Hate. Mësohet se togat e zeza të kryeqytetit e kanë liruar 37-vjeçarin që më 22 nëntor, por lajmi është bërë publik ditën e djeshme. Geldo Hoti u arrestua në pikën e Kalimit Kufitar Kakavijë më 5 tetor, ndërsa mohoi para gjykatës se tentoi të arratisë nga Shqipëria. Gjykata e Tiranës kishte caktuar masën e arrestit me burg me afat 45-ditor



ndaj tij. Sipas prokurorisë, Hoti gjendej në shoqërinë e grupit të Ervin Matës, kur ndodhi ngjarja dhe dyshohet për akuzën e "vrasjes ndaj dy dhe më shumë personave mbetur në tentativë". Në seancën me dyer të mbyllura të

zhvilluar më herët, i dyshuari, që është vëllai i një DJ të njohur në Tiranë, pranoi se është gjendur në shoqërinë e biznesmenit Ervin Mata dhe komandos Mevjol Bilo, por se nuk kishte asnjë rol në krimin e rëndë. "Në lokal "Monopol" kam shkuar bashkë me Ervin Matën, Mevjol Bilon dhe një person tjetër. Pronari na hapi një shishe verë. Nuk kaloi shumë dhe erdhën 3 persona. Ervin Mata u ngrit dhe takoi njërin prej tyre. Papritur në dorë hynë dy persona të tjerë. Njëri prej tyre filloi të debatonte me Mevjol Bilon dhe u zunë. Njëri ori armën. Pati shkëmbim zjarri", -ka thënë para trupit gjyqës Geldo Hoti.

## UNIVERSITETI 'LUARASI' LEKSIONI I HAPUR

Leksion i hapur mbi vlerat dhe aktivizmin. Mimoza Hajdarmataj: Është një institucion model

Voltiza Duro

Mësimi i vlerave dhe aktivizmi në shoqërinë civile është një nga parimet themelore për të formuar gjyqtarë model për të ardhmen. Brenda këtij kuadri, universiteti "Luarasi" i është bashkuar fushatës 16 ditore "Orange the World: #HearMeToo". Kjo fushatë botërore synon mbrojtjen e grave dhe vajzave nga të gjitha format e dhunës. Në bashkëpunim me Qendrën e Grave në Shërbim Publik, studentët e Fakultetit Ekonomik në "Luarasi" kanë ndjekur leksionin e hapur "Marketingu i Organizatave Joqeveritare dhe i Qeverive".

### PËRSHTYPJET MBI "LUARASIN"

Drejtoresha e Qendrës së Grave në Shërbim Publik, Mimoza Hajdarmataj u ka shpjeguar studentëve sesi mund të fuqizohet roli i grave dhe vajzave nëpërmjet edukimit. "Qendra Gratë në Shërbim Publik është një organizatë joqeveritare, e cila operon në fushën e shoqërisë civile dhe ka për mision fuqizimin e grave dhe vajzave nëpërmjet edukimit. Ashtu si shumë organizata të tjera, shumë aktorë e faktorë kombëtarë e ndërkombëtarë, të gjithë bashkë jemi bërë në nisim e 16 ditëve të aktivizmit kundër dhunës me bazë gjinore. 16 ditë të aktivizmit është një nisim ndërkombëtar, e përvitshme, që bën bashkë gjithë botën nën një moto "Stop dhunës ndaj grave", - tha Hajdarmata në fjalën e saj. Më tej ajo shtoi se e vlerëson "Luarasin" si një universitet model për vlerat që përcjell në shoqëri. "Universiteti 'Luarasi' është një universitet i hapur drejt djesh, i hapur drejt bashkëpunimit meshoqërinë civile. Undjmë shumë komodë në bashkëbisedimin me studentët. Ne jemi shumë të nderuar që ishim këtu dhe ndamë informacione me studentët e universitetit 'Luarasi'. Kemi moto fuqizimin nëpërmjet edukimit dhe është pikërisht

# "Luarasi" i bashkohet fushatës "Orange the World" kundër dhunës

## Aelita Mani: Përgatitim studentët për tregun e punës



Drejtoresha Mimoza Hajdarmataj dhe shefja e Departamentit të Administrim-Biznesit, Aelita Mani pas leksionit të hapur në "Luarasi"

### AELITA MANI

"Mundësitë e punësimit janë pafund dhe ne përipiemi t'i përgatitim studentët tanë të shikojnë të tëra alternativat dhe mundësitë për të qenë vetadministruer të vetes, të të ardhurave dhe mundësitë të punësimit. Ky është një treg i pahulumtuar ende dhe studentëve në këtë mënyrë iu tregojmë se duke u aftësuar me njohuri edhe për këtë treg, ata kanë shumë mundësi punësimi në këtë sektor", - u shpreh shefja e Departamentit të Administrim-Biznesit në "Luarasi".

ky universitet, i cili tashmë po jep shembull për vlerat që përcjell, studentët janë shumë të angazhuar dhe jo vetëm në botën akademike, por edhe në aktivizmin. Ne kemi një marrëveshje bashkëpunimi dhe në kuadër të kësaj marrëveshjeje, organizata jonë së bashku me universitetin kemi çelur siparin e aktivitetëve", - tha më tej drejtoresha e Qendrës së Grave në Shërbim Publik.

### LEKSIONI I HAPUR

Shefja e Departamentit të

Administrim-Biznesit në "Luarasi", dr.shk. Aelita Mani thekson se leksione të tilla përgatitjen profesionalisht studentët për tregun e punës. "Në universitetin 'Luarasi' u zhvillua ora e hapur 'Marketingu i Organizatave Joqeveritare dhe i Qeverive' me studentët e Fakultetit Ekonomik të degës Administrim-Biznes dhe Financë. Është një orë konkrete dhe në kuadër të një fushate mbarëkombëtare për sensibilizimin e brezave për dhunën

kundër grave dhe vajzave. Është një orë konkrete për t'u treguar atyre sesi marketingu është së pari një praktikë sociale për masat, konsumatorët dhe popullin mbarë. Studentët tanë e perceptojnë marketingun në funksion të biznesit, pavarësisht nga forma e organizimit të tij, por për ta është më e vështirë që të perceptojnë faktin se marketingu mund të përdoret edhe nga organizatat joqeveritare për misionin dhe punën e tyre", - thekson

### Aktiviteti



### MIMOZA HAJDARMATAJ

"U ndjmë shumë komodë në bashkëbisedimin me studentët. Ne jemi shumë të nderuar që ishim këtu dhe ndamë informacione me studentët e universitetit 'Luarasi'. Kemi moto fuqizimin nëpërmjet edukimit dhe është pikërisht ky universitet, i cili tashmë po jep shembull për vlerat që përcjell, studentët janë shumë të angazhuar dhe jo vetëm në botën akademike, por edhe në aktivizmin", - tha më tej drejtoresha e Qendrës së Grave në Shërbim Publik.

Mani. Ajo më tej shton se 'Luarasi' synon përgatitjen sa më mirë të profesionistëve në tregun e punës. "Ishte mundësia më e mirë për të konkretizuar se si një orë marketingu në funksion të marketingut për OJF-të mund të jetë një shembull konkret në funksion të një aktiviteti të caktuar dhe pse jo duke sensibilizuar edhe studentët tanë të jenë pjesë e aktivitetëve të tilla. Ata e mendojnë veten e tyre më së shumti në administratë publike, goftë kjo private apo shtetërore, por gjithmonë në funksion të biznesit. Kjo është ajo çka bën 'Luarasi', pra ndërthur aspektin teknik, akademik dhe të vlerave. Kjo, pasi ne i përgatitim studentët tanë për nesër, jo vetëm për të qenë teknikienë shumë të mirë, por edhe qytetarë me vlera në shërbim të komunitetit dhe të njëri-

tjetrit. Mundësitë e punësimit janë pafund dhe ne përipiemi të përgatitim studentët tanë të shikojnë të tëra alternativat dhe mundësitë për të qenë vetadministruer të vetes, të ardhurave dhe mundësitë të punësimit. Ky është një treg i pahulumtuar ende dhe studentëve në këtë mënyrë iu tregojmë se duke u aftësuar me njohuri edhe për këtë treg, ata kanë shumë mundësi punësimi në këtë sektor", - u shpreh shefja e Departamentit të Administrim-Biznesit në "Luarasi". Nëpërmjet praktikave të tilla, "Luarasi" vazhdon të mbetet një ndër liderët e arsimit të lartë në vend, duke sjellë përvojën më të mirë pranë studentëve e duke i përgatitur më së miri profesionalisht për të qenë të suksesshëm në tregun e punës.



Gjatë leksionit të hapur dje në "Luarasi"





# Skënderbeu dhe flamuri kombëtar shqiptar, nën mistikën e numrit "33"

Albert Hitoaliq

Në vitin 1468, pak kohë pas vdekjes së Skënderbeut, Ferdinandi i Aragonës i dërgon një letër së veshë së Heroit. Me këtë rast, në letër shkruhet "Scandalibech". Serembe mendon se kemi të bëjmë me një kriptogram të jashtëzakonshëm, të habitshëm, sfidues, grishës, marramendës. Është një fjali konvencionale, e cila duhet ta shpërthejë substancën e saj në secilën germë në vetvete, gërmë nismëtare, kuptimore, kumtmbartëse. Gjithë misterit lidhet me lehtësinë e të lexuarit nga e djathta në të majtë, pra në të kundërt, sipas leximit arab dhe jo atij latin.

Kështu kemi të bëjmë me këto germa iniciale të mëdha: H. C. E. B. I. L. A. D. N. A. C. S.

Duke plotësuar germa nistore me fjalë latine, formojmë përfundimisht, ultimisht, konkretisht, fuqimisht, lehtësisht, mrekullisht dhe marrëzisht, këtë fjali: HUMILITER CORNU EPISTOLAE BARBARIS IN LOCO ANGSTO DOMINI NOSTRAE ALBANIAE CELAT SEPULERUM.

Një përkthim i lirë i kësaj latinishtje hieronimase, na ofton se Zoti i Shqipërisë (pra Gjergj Kastrioti Skënderbeu) e ka të vendosur salmën (kufomën) në një vend të ngushtë pranë altarit, në krah, ku lexohet Epistula. Cila Epistula (Letra)? Një Epistula biblike si ato të Shën Palit, apo një Epistula Testamentum, e vetë Skënderbeut? Serembe nuk e fillëzon enigmën e Epistula-s. Këtu nis terri. E padepërtueshja. Mbaje Serembe ishte frymëzuar nga Kabala, ku kombinimi i gërmave përfiton krijesa fantazmagorike. Një shkrimtar entuziast do ta besonte, do të thurte subjektin tronitës, ku përtej të Pabesueshmes gjallon e Besueshja.

Por një shkrimtar i tillë nuk ka lindur ende. Për fatin e mirë shkrimtarët mediokër janë indiferente, trillet e dijes për ta janë kotësi shqetësuese, bezdisëse. Serembe shpiku një ide, bëri piedestalin për një monument të mangët, parashitë, por nuk vërtetoi. Këmbëgjall, por nuk gjeti dot asgjë. Hodhi një fishkëzjarr, por terri nuk u tërhoq. Parandjeu, bëri një nisje, por nuk arriti. Skeptikët nuk guxuan ta mëshirnin, as ta përkëdhelnin. Skënderbeu i gjallë ishte pa varr. Por edhe pas vdekjes nuk i duhet varri. Varrri? Një rrobë e gardërobës funerare? S'ka nevojë heroi për këtë rrobë simbolike? (Moikom Zeqo, Vdekja e Gjergj Kastriotit, Tiranë: Zenit, 2018, f. 40-41).

Ky fragment kaq grishës, i shkëputur nga botimi i studiuës Moikom Zeqo, gërsheton në brendësi mistikën me tokësoren. Moikom ngjan si një "orakull" i lashtë i dheut të tij. E interpreton kohën në një mënyrë të harruar: zbrërthen simbolikën, dhe nga ana tjetër u vendos simbole orientuese ngjarjeve, personave, historisë. Përmes stilit të tij të veçantë, ai arrin të zbulojë një gjeometri krejt të paparë të realitetit, me trajektore mistike, që pikëpër pikë na japin figura që mund të dallohen vetëm me kaleidoskopin e tij. Këtë grafikë të padukshme ai e zbulon edhe të Serembes. Skicën që portretizon anën e padukshme të historisë, atë matanë perdes së tokësore, që ka lidhje me Heroin tonë kombëtar, Moikom i e beson. Sikundër edhe Serembe. Por, a mund të ekzistojë një shkencë sekrete, e cila të flasë përmes gjuhës së enigmave historike? Ngjan se këtë gjuhë enigmash, Moikom, e sheh si ndonjë frymëzim të mundshëm të Serembes, nga "Kabala". Ky pikëshikim meriton vëmendje.

Ndoshta do të duhej një humulum më i plotë mbi dimensionin mistik të Gjergj Kastriotit. Por, teksa përmendet, me vend, Kabala si mistici i lingvistik, për të krahasuar këtë enigmë lingvistike, mundemi që këtë nivel mistici mbi Skënderbeun, ta kërkojmë edhe te "Gematria". Pra, enigmën lingvistike, të përqipim ta kryqëzojmë me mistikën numerike. Të kuptohemi drejt: nuk është aspak përpjekje për të gjetur "lidhje" të Skënderbeut me Kabaletën apo gematrian, në vetvete. Gematria është një nga mënyrat hebraike për të zbuluar kuptimet e fshehta të teksteve kanonike etj., përmes tjetërsimit të gërmave në numra. Çdo gërme i përket një numër i caktuar. Metoda e përllogaritjes numerike të gërmave, e përdorur nga hebrejtë, ka si përdorues më të lashtë akoma, grekët e vjetër dhe babilonasit. Kjo është numerologjia, e cila lidh në një sistem të vetëm, hyjnore me tokësoren; universin e brendshëm të njeriut me universin e yjesive. Nëse në fillim ishte Fjala/zëri/tingulli, në zemër të këtij vibrimi të pashtëshëm universal qëndronte, qëndron dhe do të qëndrojë numri. Numri, vibrimi dhe gjeometria universale apo e shenjtë, - këta janë tharimi i një trinje të pakohë, e cila, përshkruhet kështu nga Pitagora: "Numri sundon gjithësinë". Ky sundim universal na bën të barabartë: njerëz edhe vje, nën një parim unik universal, nën një ligjësi të vetme, nën një skicë të pandërprerë gjeometrike universale. Në thelb, kjo është studiumi në tërësi nga shkollat e mendimit ezoterik, përmes sistemeve të tyre të njohurive okulte. Mora shkas nga interpretimi i Serembes prej Moikomit, i cili ngacmon këtë metodologji "kabaliste" të gërmimit për kuptimet e fshehura, për të sjellë në vëmendje disa përkime numerike rastësore (?) që lidhen me figurën e Gjergj Kastriotit.

## NUMRI "33", NUMRI "333", FLAMURI SHQIPTAR DHE MISTIKA E TIJ

Ashtu siç u përmend, numerologjia njihet përdorime sistemesht të ndryshme. Sistemi kaldeas apo kaldean, është sistemi më i lashtë i numerologjisë. Kaldeasit apo babilonasit e dikur-



Kartolina e Spiridon Ilos, 1920

Kujtim për ditën e lirisë që u ngrit Flamuri në Vlorë 28 Nëntor 1912

shëm përparuan shumë në artet e praktikës së magjisë dhe studimit të çështjeve magjike të natyrës. Ata u thelluan shumë në studimin e astronomisë për të arritur zbulimin e të ardhmes përmes yjeve, gjë që ne e quajmë astrologji. "Babilu", Porta e Perëndisë, apo Babeli i famshëm i kullës së përpshijës të gjuhës së njeriut, i përket kësaj populsi, e cila përdorte këtë sistem numerologjisë. Sipas këtij sistemi numerologjisë, gërmat konvertohen në të njëjta numra, nga njëshi deri te teta, - numra të cilët përfuthehen me sistemin diellor babilonas, i cili njihet te të planetët, përfshirë këtu edhe Hënë. Numri 3 i këtij sistemi është ai që i përket Jupiterit.

Nëse llogarisim sipas kësaj mënyre, shkurtësisht GCS (Georgius Castriotes Scanderbeg), del numri 333 dhe totali 9; ndërsa po sipas kësaj mënyre llogaritjeje, nga emri Scanderbeg del numri 33. Emri "Skënderbe" jep numrin 33. Emri "Iskanderbeg" jep edhe ai numrin 33, kurse "Georgius", jep numrin 30, që është përsëri rrjedhim i numrit tre, por bashkëtingëlloret "G" dhe "S" që hapin dhe mbyllin emrin, krijojnë numrin 33. Nëse do të kërkonim një numër që do të ishte simbolik për Skënderbeun, sipas kësaj mënyre përllogaritjeje, ai do të ishte numri 33.

Më datë 28.11.1443, Skënderbeu ngriti flamurin me shqipen dykrenore dhe mbollti idenë e pavarësisë shqiptare, e cila do të vulojë në po të njëjtën datë, në vitin 1912, nga më i famshmi për fisit Vloraj, Ismail Qemal bej Vlorë. Nëse shohim datën e parë të ngritjes së flamurit, numrat e saj të mbledhur deri në nxjerrjen e një numri të vetëm janë 2+8 / 1+1 / 1+4+4+3, që në vetvete sjellin 1.2.3, apo shumën 6. Por, nëse llogarisim emrin "Ismail Vloraj", ai jep numrin 33. Përdorimi i mbiemrave në Vlorë shoqërohet gjithnjë me një gërmë "J" nga pas dhe ai ishte një Vloraj. Por, nëse llogarisim versionin "Ismail bej Vlorë", i cili jep numrin 40, mund ta gjejmë atë, të shoqëruar me llogaritjen e emrit "Gjergj Kastrioti", i cili po ashtu jep numrin 40. Përkimet duket se nuk mbarojnë me kaq. Llogaritja e emrit "Ismail Qemali" dhe "Ismail Kemal", jep numrin 28. Ndërsa shuma e vitit kur Skënderbeu ngriti flamurin, "1+4+4+3", jep numrin "12", që si për ironi është 12-ta e Pavarësisë.

E si për t' të mos përfunduar këtu, edhe flamuri kombëtar, me shqipe dykrenore, është pjesë e këtyre përkimeve. Nëse llogarisim emrin "shqipe" ai jep numrin 23, por fjala "dykrenore" jep përsëri numrin 33, e të dyja bashkë, na japin tre treshat: 333. Numri 3, sipas tabelave të numerologjisë kaldease, i përket Jupiterit, i cili në mitologji shoqërohet me Zeusin. Skënderbeu vulën e tij sekrete e kishte me tematikën erotike të Zeusit dhe Ledës: atij Zeusi pellazgjik dodonas, që sipas Homerit mbretëronte në Dodonën dimërkeqe. Nëse llogarisim versionin "Dodonea" të emrit ai jep përsëri numrin 33.

E si për t' të vendosur "vulën" me numrin 33, data e ngritjes së flamurit, është pikëtakimi i trajektoreve historike. Skënderbeu e ngriti flamurin më 28 nëntor, kur kishin mbetur edhe 33 ditë nga mbjllja e vitit 1443. Por, ngritja e flamurit kombëtar nga Ismail Qemali dhe shpallja e Pavarësisë së Shqipërisë, - në rrjedhën e rastësive të mësipërme, - përkon me një vit të brishtë. Shqipëria u shpall e pavarur në vitin e brishtë 1912, që do të thotë se ai vit kishte një ditë më shumë se të tjerët, gjë që siç dihet, përsëritet çdo katër vjet. Më 28 nëntor 1912, Shqipëria u shpall e pavarur: Kjo ndodhi në ditën e 333-të të vitit, kur ky vit donte edhe 33 ditë të tjera për tu mbyllur. Cila mund të ishte pamja e saktë e flamurit që u ngrit atë ditë?

Studiuesi vlonjat Pirro Stefa, disa vite më parë ka siguruar një kartolinë të vjetër (ose kartë postale në terminologjinë e kohës), të botuar nga Spiridon Ilo (firmëtar i aktit të Pavarësisë Kombëtare) në vitin 1920, ndërkohë që ky i fundit llogarhej sërish në emigrim, në Boston (SHBA). Sipas studiuës Stefë kartolina riprodhon saktësisht flamurin origjinal. Spiridoni, me origjinë nga Korça jetonte prej vitesh në Bukuresht dhe kishte afërsi familjare me korçeran Marigo Posio (mbiemri i vajzërisë Poçi). Ka historianë që mendojnë

kartolinën e tij. Ç'rëndësi do të kishte që të dinim nëse ky flamur i Spiridon Ilos, të ishte riprodhim i saktë i formës së origjinalit? Versioni i Spiridon Ilos përmban edhe ai në vetvete një përkim numerik thuajse të pabesueshëm, po që se marrim parasysh të gjitha rastësitë e dëritanishme. Në një artikull të vitit 2012, Agim Morina sjell një vëzhgim interesant mbi këtë formë të Flamurit të Pavarësisë, i cili është ai i kartolinës së Ilos:

"Qysh i vogël derisa lexoja historinë e popullit shqiptar, jam mahnit me pamjen e shqiponjës së vitit 1912 në një riprodhim të dobët fotografik në librin e historisë. Ajo shqiponjë më duket ma e fuqishme, ma elegante dhe ma krenare, sidomos kur e krahasoj me shqiponjën që valonte në flamurët zyrtarë. I shtytny prej kësaj dëshire për me e pa në ngjyra ma të forta dhe ma të qarta pata ba disa herë disa kopje të kësaj shqiponje. Në punë e sipër më duhej doemos me e pa me shumë kujdes çdo detal e me numëru çdo flatar të shqiponjës. Dhe kjo, doemos, më solli në një përfundim të papritur: pendlat e krahëve të shqiponjës më dolën me qenë 14+14 që bashkë bëjnë 28! Natyrisht, mendja më shkoi te dita 28 e nëntorit, në të cilin që ngritë flamuri ynë në Vlonë. Mendova se mund me qenë rastësi, por kur numërova edhe pendlat e bishtit të shqiponjës dhe më dolën 11 atëherë fillova me mendu se këtu ka diçka ma të ndërjegjishme sepse dilte dita 28 dhe muji 11. Mandej, m'u duk e kotë me këru edhe vitin 1912, sepse kjo ishte e pamundur. Mirëpo, si duket nuk kishte qenë krejt e pamundur për dizajnerin! Kur numërova kreshtat në qafë e dy krenave të shqiponjës më dolën 6+6 që bëjnë 12. D.m.th. dizajneri i shqiponjës e kishte shkurtu vjetin 1912 në 12. U gëzoza shumë që flamuri ynë ishte qëndisë dhe ishte dizajnu me aq dashuri e kujdes. Ky përfundim ndihmon edhe në anën historike për me ditje ma me saktësi çashtjen e datës se kur ishte vendosë me u ngritë flamuri. Dizajnimi çm kah ideja se ose data 28 Nëntor ka qenë e paracaktume dhe e ditjen disa kohë ma parë, ose flamuri asht qëndisë mbrenda një nate derisa Ismail Qemali udhëtonte për në Vlonë. Sidoqoftë, kjo gja le t'u mbetet për shqyrtim historianëve" (Agim Morina, "Simbolika e shqiponjës në vitin 1912", Dervina.com, 2012).

Nëse mbledhim numrat që janë vendosur sipas renditjes së flatrave/pendëve të shqiponjës së flamurit kombëtar të ngritur më 1912 në Vlorë, do të kishim një përkim tjetër: (2+8)•11=28. Shuma të tre grupeve do të ishte: 10+11+12. Del përsëri numri 33.

Po ç'përfaqëson numri 33 apo numri 333. Ka material të bollshëm mbi mistikën e këtyre numrave. Ka raste që informacioni dhe interpretimet janë qesharake e jobëndëse, ashtu siç ka raste që interpretimet mund të të fusin në mendime. Nuk do i sjell të gjitha në këtë shkrim pasi është e pamundur dhe do të mbusheshin faqe të tëra. Të gjitha sa thamë mund t'i trajtojmë siç thotë Ajnshtajni: "Ka vetëm dy mënyra për ta jetuar jetën: Çdo gjë është një mrekulli ose asgjë nuk është një mrekulli".

Po mjaftohem të sjell dy qasje simbolike. Masonët (Frimasoneria) e kanë si simbol të tyre numrin 33 e madje të shoqëruar edhe me trekëndëshin barabinjës dhe shqipen dykrenore. Ndër shumë e shumë lidhje e interpretime që i bëjnë këtij numri me shoqëritë sekrete, më duket i vlefshëm për tu përmendur këtu, ai i krahasimit me vertebra e shtyllës kurriorezore. Njeriu ka 33 vertebra. Këto janë simboli i shkallëve të masonerisë, i ngritjes drejt nivelit sipëror; atij me numrin 33. Shkalla 33 është më e larta e lozhës masonike. Rituale e masonëve shumë studiues i lidhin me tempullarët dhe, këta të fundit, kishin marrë një pjesë të praktikave nga sofizmi. Jenicerët po ashtu ishin praktikues të sufizmit, pasi ishin bektashinj. Fuqia shpirtërore, tejkalmi i fuqive fizike të njeriut normal, kryerja e veprimeve të mrekullueshme apo njohja e atyre elementeve që më pas i përdor edhe alkimia mund të gjujrohen te këto rituale që vinin kushedi se nga ku e kushedi se nga ç'thellësira antike. Duke ju kthyer rishtas simbolikës së vertebrae, numrit 33, mund të shohim se shpallja e Pavarësisë nga Ismail Qemali, është ndërtimi i shtyllës kurriorezore kombëtare. Kjo është ngjizur me frymë mistike dhe pavarësisht historisë tragjike të Shqipërisë, ngjan me një strukturë e cila do na mbajë gjatë më këmbë. Jemi një popull i mbijetuar, e ky është akt force. Mbijetësi tregon se kemi shtyllë kurriorezore.

Nëse simboli i parë ishte qëndrueshmëria, ai dytë është drita. Masa e Diellit, sipas NASA-s është 333.000 herë më e madhe se sa ajo e Tokës. Numri 333 i Skënderbeut, është numri 333 i yllit tonë gravitacionit kombëtar, rreth të cilit do të rrotullohet përjetë identiteti dhe ngjizja jonë kombëtare. Ai është drita e lirisë dhe ashtu si Dielli, ajo dritë dhe ky simbol kombëtar, janë të patjetërsueshëm, të pazvëndësueshëm e të pashtatërsueshëm. Janë burim frymëzimi, shprehëse të jetë, - sepse janë simboli pozitivizmi universal, simbol triumfi mbi fuqitë shkatërruese. Mbetet të përsëritet edhe një 33 e tretë dhe shqiptarët do të ngrihen përsëri në dritë!





## BOTIMI

# Harta e rrallë e 1455-ës për Papën Nikolla V, Arbëria me emrin Scanderbeg

Fatmira Nikolli

Ruhet si më i vjetri artefakt në bibliotekën e qytetit të përjetshëm. Është një hartë në një lëkurë viçi ende të palindur më 1455. Jemi dy vjet pas rënies së Kostandinopojës. Mbretëron lavdiplotë Papa Nikolla i V e një nga hartografët më të shquar shkruan mes emrave atë të një kryezoti-Scanderbeg.

Këtë emër që Papa Piu i II do të mposhtë shekujt. Nëse do kish qenë një mit a një kaçak gjakatar, ky emër nuk do të ishte shkruar". Kryeministri Edi Rama e mbyll me këto fraza fjalimin e gjatë që citon papë të Romës e historianë të Shqipërisë, e deri te Imzot Fan Noli mbi Skënderbeun. Ka përmendur ndërkaq ç'është bërë gjatë këtij viti, ka thënë se historianët e kanë kapur me të, ka cituar letra e shkresa kur përmend modestinë e ndërtimin e një biblioteke të re kombëtare. Shefi i qeverisë thotë se nëse qe e vërtetë që Napoli e Roma u ndanë në borxhe me

Prezantohet nga kryeministri Rama, u gjet në Bibliotekën e Romës nga Artan Shkreli



Harta detare Një, e njohur si Carta Nautica Uno

Skënderbeun, me këtë hartë i lajnë borxhet. Ajo u ekspozua në mbyllje të vitit jubilar mbarëkombëtar të Gjergj Kastriot Skënderbeut dhe në prag të festave të nëntorit. Duke i dhënë peshën e një ngjarjeje, në

një mbrëmje speciale mes të ftuarve e personaliteteve të shquar nga bota akademike, e kulturës, artit, medias, shoqërisë civile, trupit diplomatik, Edi Rama vuri në dukje jo vetëm emrin e Skënder-



Harta detare Një, e njohur si Carta Nautica Uno, që u shfaq dje është një artefakt i rrallë i realizuar në vitin 1455 nga kartografi gjenovez Bartolomeo Pareto për Papën Nikolla V. Ajo ruhet në Bibliotekën Kombëtare Qendrore të Romës dhe paraqitet në formën e një portulani me finesë të rrallë grafike dhe cilësi teknike të përkryer. Harta shquan për nga prania e mjaft elementeve dekorative si edhe nga shenjimi i vendeve me interes të posaçëm; mes të tjerash ajo dëfton bashkëkohësi ngjarjesh historike në mënyrë të veçantë trysinë osmane në Evropë e sidomos në Gadishullin e Ballkanit.

Në hapësirën e gjerë të Arbrit e përtej bie në sy një toponim i pashoq që evokon Gjergj Kastriotin. Ky toponim mu në qendër të hartës, përfaqëson jo vetëm një zbulim të mirëfilltë në rrafshin albanologjik, por edhe një kontribut në ndritjen e personalitetit real përkundër përplekëve të vazhdueshme demitizuese si mbrojtës i identitetit mijëvjeçar të "Evropës së popujve".

beut por edhe lavdinë e tij të pasuar. Pas tij, fjalën e mori studiuesi Artan Shkreli, që e ka gjetur hartën në Romë. Ai tha se ajo qe zhdukur për dy shekuj, deri sa u gjet në një bibliotekë të murosur. **HARTA**

## Menaxherë! Puna ju çon në çdo cep të botës.

Planifikoni mirë. Udhëtoni të sigurtë!

Sigurimi i Jetës dhe Shëndetit në Udhëtim është garancia juaj për udhëtim dhe qëndrim jashtë shtetit, konform të gjitha standardeve të kërkuara për lëvizjen e qytetarëve kudo në botë.

- Mbulim të shpenzimeve mjekësore jashtë Shqipërisë
- Mbulim të shpenzimeve për riatdhesimin në rast sëmundjeje apo humbje të jetës
- Dëmshpërblim në rast të humbjes së jetës



**SIGURIMI**  
i JETËS dhe SHËNDETIT  
në UDHËTIM

**SiCRED**  
Shoqëri Sigurimi Jete

# VIP

Suplement  
*Pages*

Emërkurë 28 Nëntor 2018 GAZETA SHQIPTARE

## "BULEVARDI POLITIK"

- Edhe Enver Hoxhaj si Ali Ahmeti, ngatërro shqiponjën
- "Bëmë baba të të ngjaj", vajza e Auron Tares zbulon pasionin
- Moment pikant nga Peja, Rama tërheq me forcë dorën e Haradinajt, ia vendos mbi flamur
- Melania Trump hap dyert e Shtëpisë së Bardhë për Krishtlindje

S'keni për ta njohur! Ja si dukej Rita Ora fëmijë



Nik Xhelilaj na bën krenarë! Sjell në jetë poezinë e Dritëro Agollit në Gjermani



Nga Agnesa Vuthaj, te Rudina Magjistari, ja cilët janë VIP-at që vishen nga stilistja

# Stela Sallaku:

## Vishuni nga garderoba juaj kapsulë, mbi të gjitha jini vetvetja



**Intervista**

Nga Agnesa Vuthaj, te Rudina Magjistari, ja cilët janë VIP-at që vishen nga stilistja

# Stela Sallaku:

## Vishuni nga garderoba juaj kapsulë, mbi të gjitha jini vetvetja

*"Puno fort dhe mos u var nga askush"*

Ajo është një nga stilistet e më në zë të vendit, e cila në moshë fare të re arriti të kishte ndikimin dhe pozicionin e saj në fushën e modës. Jo vetëm si stiliste, por edhe si editore mode në një nga portalet 'online', Stela Sallaku na sjell më të rejtat e kësaj fushe çdo ditë në rubrikën e saj. Në një intervistë për "Vip Pages" të "Gazeta Shqiptare", Stela ka rrëfyer rrugëtimin e saj për të ardhur këtu ku është sot. Si lindi pasioni për modën si dhe muza e saj, e cila e frymëzon çdo ditë me krijimtaritë që sjell për klientët. Duke qenë një studiuese dhe stiliste e veshjeve e trendeve të fundit, ajo gjithashtu ka përmendur edhe disa nga VIP-at, të cilët 'vishen' tek ajo duke i besuar dhe zgjedhur stilin e saj.



**ijimet tuaja?**

Muza ime ka qenë Ava Gardner, çdo dizajn e imagjinoja tek ajo fillimisht.

**Përveç pasionit për modën, të cilin e keni zgjedhur dhe si profesion, me çfarë mer-**



**ret tjetër Stela në përditshmërinë e saj?**

Unë prej një viti jam editore mode në "Tiranapost.al", ku kam një rubrikë çdo ditë. Secila është e veçantë, por qëllimi kryesor është të promovojmë

veshjet unike dhe të personalizuara, të vishesh mirë, por pa shpenzuar shumë.

**Nëse s'do të zgjidhnit botën e modës, cila do të ishte zgjedhja juaj e dytë?**

Nuk e di, ndoshta arkitekturë. **Çfarë quan Stela "in" për të veshur në këtë periudhë të vitit?**

Fustanet e leshta në një nga nuancat e tokës.

**Duke qenë se jeni studiuese dhe stiliste e veshjeve e trendeve të fundit, padyshim do të keni edhe ndonjë VIP, i cili ndjek sugjerimet tuaja apo dhe vishet nga punimet tuaja. Mund të përmendni ndonjë?**

Disa nga mikeshat e mia të njohura, të cilat janë veshur me krijimet e mia janë Fatma Haxhiali, Irena Kita, Rudina Magjistari, Orinda Huta, Agnesa Vuthaj, Mira Kazhani, Iva Tico etj.

**A keni qëlluar me klientët të vështirë? Si e keni menaxhuar situatën?**

Klientët janë të veçantë dhe unikë. Nuk do i konsideroja të vështirë. Me secilin kemi punuar veçmas, në mënyrë të ndryshme.

**Nëse do të zgjidhnit një periudhë kohore ku të jetonit sipas trendeve të modës, cila do t'ju përshtatej më tepër tipit dhe stilit tuaj?**

Vitet '50-60.

Si profesion dhe pasion stilimin, që në Shqipëri është i



vështirë për t'u ushtruar, duke qenë se kërkon një investim të vazhdueshëm dhe të konsiderueshëm monetar dhe kohor. A keni pasur ndonjë moment që do të kishit dashur të tërhiqeshit? Pse? Ka gjithmonë ditë kur them se do dal në pension të parakohshëm (qesh). Jo, është pat-



jetër e vështirë, por rezultati final ia vlen pa dyshim.

**A keni pasur bashkëpunim me ndonjë stilist të huaj? Nëse jo, me kë do të donit të kishit?**

Nuk kam pasur bashkëpunime me stilistë të huaj. Por nëse do kisha, do ishte Magda Butrym.

**Çfarë këshille do t'i jepnit dikujt që ka pasion modën? Puno fort dhe mos u var nga askush.**

**Së fundi, njerëzit po përpigën gjithnjë e më tepër të jenë sa me "in" me trendet e fundit. Ç'sugjerim do të mund të jepnit për të rinjtë në mënyrën e të veshurit?**


Vishuni nga garderoba juaj kapsulë, nëse nuk keni mundësi të visheni sipas trendit. Mbi të gjitha, jini vetja.

Pamela Aliaj

Jeni një nga stilistet që pikasni me shijet tuaja dhe stilin e veçantë. Si nisi pasioni juaj?

Thjesht fare, në një ambient shumë modest, i cili u konceptua si atelier fillimisht. Më pas si "showroom" dhe tani kryesisht po punoj vetëm me koleksione.

**A ka pasur një muzë Stela në fillimet e saj apo edhe tani, që ju ka frymëzuar në kr-**






**P**as festës së djeshme të ditëlindjes së saj të 27-të, këngëtarja me famë ndërkombëtare, Rita Ora ka postuar një sërë fotosh nga e shkuara e saj. Mesa duket, ylli i "Let you love me", është bërë nostalgjike dhe ka vendosur t'i rikthehet të fëmijërisë, duke ta treguar se si dukej e vogël. Një vogëlushe me flokë kaçurrella, ngjyrë kafe, me sy që shkëlqenin e plot jetë. Rita që fëmijë duket se kishte ëndje për të qenë në qendër të vëmendjes, duke dalluar nga gjithë të tjerët. Sa e ëmbël, me një buzëqeshje të pafajshme, përveç flokëve biondë, asgjë tjetër s'ka ndryshuar tek këngëtarja shqiptare.

**S'keni për ta njohur! Ja si dukej Rita Ora fëmijë**

## Fëmijë i dytë për Hygerta Sako? Ja si përgjigjet ish-misi



**H**ygerta Sako, në një intervistë të dhënë së fundmi ka foli gjatë për eksperiencën në televizion dhe jetën e saj private. Ish-misi, nënë e një vajze 12-vjeçare, e pyetur nëse në planet e saj të së ardhmes është një tjetër fëmijë. "Për një fëmijë të dytë e kam menduar, sepse Ana është shumë e dhënë pas fëmijëve të vegjël dhe unë e kuptoj që ndoshta për të kjo është një mungesë e madhe", - u shpreh Hygerta, e cila pohoi se nuk beson më të një martesë e dytë. "Te martesë e dytë nuk është se besoj. Ndoshta është edhe çështje mentaliteti, pavarësisht se unë jam shumë mendjehapur ndaj kësaj teme. Ose ndoshta ka të bëjë edhe eksperiencia ime e parë e martesës, e cila nuk eci siç doja unë". Përsa i përket një partneri të ri në jetën e saj, moderatorja tha se ai i duhuri duhet të vijë me disa kritere dhe nëse nuk i ka, më mirë të rrijë vetëm! Se ka keq apo jo?




**A**jo gjithmonë është shfaqur e rezervuar duket, një event i tillë nuk kishte se si ta bënte të heshhte. Ditën e djeshme festonte ditëlindjen djalë që i ka rrëmbyer zemrën Eliona Pitarkës. Ajo nuk hezitoi ta uronte edhe në "Instastory", duke treguar surprizën që kishte rezervuar për njeriun e zemrës. Duke e pritur në një dhomë të mbushur të mbushur plot me tollombaze dhe urime në mur, aktorja e "show"-t "2XL" tregon momentin e veçantë kur e përqafoi, por tregohet e kujdesur duke e mbuluar fytyrën e tij. Vërtet me fat djaloshi të ketë në krah bukuroshen "show"-t humoristik.

**"Edhe 100 dashuria ime!", kush është njeriu i zemrës i Eliona Pitarkës?**

## NIK XHELILAJ NA BËN KRENARË! SJELL NË JETË POEZINË E DRITËRO AGOLLIT NË GJERMANI



**P**rej kohësh ai është larguar në Gjermani, ku është pjesë e një kasti të mirënjohur në një serial të quajtur "Qumësht dhe Mjalte" nën rolin e Arian. Por, kjo s'do të thotë se ai ka harruar vendlindjen dhe këtë e ka shprehur edhe me postimin e tij të fundit. Me rastin e përvjetorit të pavarësisë, Nik na sjell një projekt nga larg për të festuar festat në Gjermani me flamurin kuqezi. Në postim ai njofton se së shpejti do të vijë në jetë një projekt 100% gjerman duke risjellë poezinë e Dritëro Agollit, "Kur të jesh mërzhitur shumë". Në postimin e tij aktori shkruan: "Kur ke shansin të interpretosh një nga poezitë më të bukura 'shqip', në një projekt 100% gjerman". Një nismë shumë e bukur e aktorit. Mezi presim të shohim realizimin e tij. Me siguri do të ketë shumë sukses.



Hudhra është e pasur me antioksidues dhe është e përsosur për t'ju mbrojtur kundër kollës dhe ftohjeve. Veç kësaj, hudhra përmban edhe substancën alicinë, që njihet për efektin e saj kundër baktereve dhe kërpudhave.



Mënyra më e mirë për ta përdorur shafranin është porsa ta ndjeni djegien në fyt, dhimbjet apo të filloni kollën. Shafrani mund ta parandalojë infeksionin, duke mos u bërë edhe më keq. Mënyra më e lehtë për ta përdorur shafranin është ta përgatisni pijen "halli drodh".

# 4 ilaçe shtëpiake kundër kollës dhe ftohjes, që me të vërtetë funksionojnë

**F**tohja e zakonshme përcillet me kollë dhe është një gjendje mjaft irrituese për t'u marrë me të. Në vend se ta "mbytni" trupin dhe organizmin tuaj me kemikate nga farmacitë, ju paraqesim ilaçet natyrale.

### Përdoroni hudhrën

Hudhra është e pasur me antioksidues dhe është e përsosur për t'ju mbrojtur kundër kollës dhe ftohjeve. Veç kësaj, hudhra përmban edhe substancën alicinë, që njihet për efektin e saj kundër baktereve dhe kërpudhave.

### Si ta përdorni:

**Këshilla e parë:** Nëse vuani nga dhimbjet në vesh, kjo mund të jetë shenjë e fytit të infektuar, që më pas shkakton kollën dhe ftohjen. Për të parandaluar këtë, shtypni disa thelpinj të hudhrës dhe vendosini në kompresë të pastër. Më pas vendosni në vesh, duke u përkujdesur të mos e shtyni tepër thellë.

**Këshilla e dytë:** Nëse vuani nga kolla dhe të ftohtët, merrni rreth 4 deri 5 thelpinj të hudhrës, i shtypni dhe hidhni në gjalpin me qumësht të lopës, apo buallicës. Po ashtu, lëngun e hudhrave mund ta përzieni me dy domate dhe lëng limoni për të përgatitur një pijë kundër viruseve.

### Trajtojeni ftohjen dhe kollën me shafran

Shafrani është i pasur me kurkumin dhe vajrat që avullohen, që përmbajnë substanca mbrojtëse kundër ftohjes dhe kollës.

### Si ta përdorni:

**Këshilla e parë:** Mënyra më e mirë për ta përdorur shafranin është porsa ta ndjeni djegien në fyt, dhimbjet apo të filloni kollën. Shafrani mund ta parandalojë infeksionin, duke mos u bërë edhe më keq. Mënyra më e lehtë për ta përdorur shafranin është ta përgatisni pijen "halli drodh". Për ta

bërë këtë pije merrni një lugë "halli" dhe ia shtoni një gotës me qumësht. E vloni përzjerjen dhe e pini derisa të jetë e nxehtë. Mund të shtoni edhe pak mjaltë, për ta

ëmbëltuar pijen.

**Këshilla e dytë:** Po ashtu, mund të pini çaj shafrani për të trajtuar këtë gjendje. Krejt çfarë duhet të bëni është të vloni 4 gota ujë,

përzieni 11 lugë shafran pluhur dhe e valoni. E lini të qëndrojë për 10 minuta. Mund t'i shtoni pak mjaltë dhe limon dhe çaji është gati.

### Pini çaj të bimëve

Pos çajit nga shafrani, që e kemi përmendur më lart, ekzistojnë edhe shumë lloje të bimëve që po ashtu u dalin në ndihmë njerëzve që vuajnë nga kolla dhe të ftohtët.

Si t'i përdorni:

**Këshilla e parë:** Përzieni në ujë 4 lëvozhgë kardamomi, 4 kokrra piper të zi, disa riska xhenxhefil dhe pak kanellë. E lini përzjerjen të valojë, ulni zjarrin dhe e lini të qëndrojë për 10 deri 15 minuta. Çajin e përzieni me pak qumësht ose mjaltë dhe e pini sa është i ngrohtë.

**Këshilla e dytë:** Po ashtu, mund të përgatisni çaj të thjeshtë me borzilok, duke shtuar 15 gjethe të pastruara në 1.5 uje. Pas rreth 10 minuta, përzieni dhe shtoni edhe 1 lugë lëng limoni dhe e pini derisa është i ngrohtë.

### Ilaçe shtëpiake për kollën me sekrecion

Nëse keni kollë me gëlbas, atëherë mund ta shëroni me ilaçe të thjeshta të përgatitura në shtëpi. Ilaçi produktiv (me gëlbas), mund të jetë simptomë e infeksioneve në gjoks, si bronkiti, pneumonia madhe edhe tuberkulozi.

### Si t'i përdorni:

**Këshilla e parë:** Merrni disa kokrra piper të zinj me pak kuminë dhe sheqer të vrugët. Shtoni pak ujë dhe valoni derisa të përzihet mirë. Ftohni dhe më pas e pini, në mënyrë që të hapni rrugët tuaja të frymëmarrjes.

**Këshilla e dytë:** Merrni disa gjethe të bimës "Piper beetle", i shtypni dhe nxirrni lëngun. Merrni rreth 2 lugë nga ky lëng, përzieni në 1 lugë mjaltë dhe përzjerjen ta konsumoni dy herë në ditë, rreth një orë pasi ta keni konsumuar ushqimin.





# BULEVARDI

Na merrni seriozisht!

## POLITIK

### Edhe Enver Hoxhaj si Ali Ahmeti, ngatërron shqiponjën

Mbledhja e të dy qeverive është mbyllur me gjestin e famshëm, bërjen e simbolit të Shqiponjës me dy duar. Ajo që bie në sy është mënyra se si e ka bërë shqiponjën Enver Hoxhaj. Hoxhaj e ka bërë "mbrapsht" shqiponjën dhe veprimi i tij po komentohet shumë në rrjetet sociale. Në të njëjtën mënyrë u ngatërrua pak ditë më parë edhe lideri i BDI në Maqedoni, Ali Ahmeti, gjatë një vizite të Presidentit Meta. Pas mbledhjes së dy qeverive, asaj të Kosovës dhe Shqipërisë, përfaqësuesit e të dyja delegacioneve dolën jashtë dhe realizuan fotografinë e mbledhjes së këtij viti. Nga këtë fotografi mund të vërejmë se si nga delegacioni kosovar, dy ministrat kosovarë, ai i shëndetësisë, Uran Ismaili dhe ministri i Administratës Publike që vjen nga radhët e komuniteteve, Mahir Yagcilar nuk e kanë bërë simbolin e shqiptarëve.



### Moment pikant nga Peja, Rama tërheq me forcë dorën e Haradinajt, ia vendos mbi flamur

Ditën e hënën u mbajt në Pejë takimi mes dy qeverive, asaj të Kosovës dhe Shqipërisë. Mirëpo, mediat në Kosovë kanë filmuar një moment të sikletshëm mes kryeministrit Rama dhe Haradinajt. Teksa dy krerët e qeverive nënshkruan mbi flamurin kombëtar, në një moment Rama i tërheq me forcë dorën e Haradinajt që ta vendosin bashkë mbi flamur.



### "Bëmë baba të të ngjaj", vajza e Auron Tares zbulon pasionin

Zv.kryetari i Komitetit Shkencor të Pasurive Nënurore të UNESCO-s, (STAB) dhe drejtori i përgjithshëm i Agjencisë Kombëtare të Bregdetit, Auron Tare, përveç përfshirjes në politikë dhe në fushën ushtarake, është dalluar si një nga basketbollistët më cilësorë të Partizanit të famshëm të viteve '80 dhe njëkohësisht lojtar i ekipit kombëtar. Por mesa duket, tradita vazhdon dhe Auron Tare këtë pasion e ka trashëguar tek e bija, Livia. Ajo është vetëm 12 vjeçe dhe është përzgjedhur në ekipin rajonal të Bostonit si lojtarja më e re. Në këtë rast, mund të thuhet me plot gojë "Bëmë baba të të ngjaj".

### Melania Trump hap dyert e Shtëpisë së Bardhë për Krishtlindje

Melania Trump hap dyert e Shtëpisë së Bardhë për festat e fund vitit. Zonja e parë e SHBA-ve, me anë të disa fotove të postuar në "Twitter" na tregon si është dekoruar për festa Shtëpia e Bardhë.



EKSKLUZIVE

# REXHHEP QOSJA:

## Jam pro shkëmbimit të territoreve me Serbinë, kundër ndarjes së Kosovës

**"Rendi i sotëm botëror i artë për ne shqiptarët, jo arnimeve të përkohshme"** Box hyrës Profesor Rexhep Qosja del pro shkëmbimit të territoreve të Kosovës me Serbinë por duke vënë disa kushte. Në një analizë të shkruar ekskluzivisht për GAZETA SHQIPTARE, ai sqaron se merret vetëm me konceptin (pra jo me detajet që u takojnë ekspertëve). Akademiku thotë se ideja ka qenë e intelektualëve më parë se të bëhej e politikës dhe se në bisedime duhet përfshuar Aleksandër Vuçiq për shkak të lidhjeve të tij me Sheshel. "Shkëmbimi i territoreve të sipërthëna, i arritur në paqe, me Marrëveshje midis shqiptarëve dhe serbëve, me pajtimin në fund të faktorëve ndërkombëtarë, me pajtimin e SHBA-së dhe të BE-së, do ta bënte më të madhe se ç'është sot mundësinë politike, kombëtare e ndërkombëtare, për zgjidhjen përfundimtare, historike, të çështjes së Kosovës: për Bashkimin e Kosovës me Shqipërinë", thekson Qosja. Ai rendit 9 porosi për bisedimet ku si fillim hyhet si të barabartë. Nga çështjet e hershme historike, te herët kur historia e bisedimit kanë çaluar, profesori thotë se do të duhej një marrëveshje që u vlen edhe atyre që nuk jetojnë më e edhe atyre që nuk kanë lindur ende.

Nga Rexhep Qosja

Ideja e shkëmbimit të territoreve mes Kosovës dhe Serbisë, e bërë publike shumë vite më parë, por e përditësuar dy muajt e fundit, tashmë është ngritur në nivelin e çështjes për të cilën po flitet në gjithë hapësirën shqiptare, madje edhe në diasporë. Çështja e shkëmbimit të territoreve është çështje, çështje politike e kombëtare e madhe, sepse është çështje që i përket tërësisë territoriale të Kosovës, tërësisë territoriale të Serbisë dhe, rrjedhimisht, qëndrueshmërisë në rajon, para së gjithash në rajonin e të ashtuquajturit Ballkanit Perëndimor.

Megjithatë çështja e shkëmbimit të territoreve ende nuk është bërë çështje e bisedimeve, për të e kanë quajtur të nevojshme, dhe të arsyeshme, ta thonë mendimin e tyre institucioneve shtetërore të Kosovës e të Shqipërisë, struktura drejtuese të partive politike në Kosovë, të partive politike në Shqipëri, të partive politike shqiptare në Maqedoni, në Mal të Zi, në Lug-

inë të Preshevës e në diasporë, mandej, intelektualë, studiues shkencorë, shkrimtarë dhe qytetarë të zakonshëm.

Për dallim prej institucioneve dhe vetëve disa prej të cilëve merren edhe me përpjesëtimin e me përmbajtjen, domethënë me vetë projektin e shkëmbimit të territoreve, unë në këtë mes merrem vetëm e vetëm me konceptin, vetëm me çështjen e shkëmbimit të territoreve, i vetëdijshëm se përpjesëtimin e përmbajtjen e saj duhet ta përcaktojnë ekspertët e të dy palëve në bisedime.

Është e kuptueshme që prej gjithë këtyre institucioneve, gjithë këtyre drejtuesve të partive, gjithë këtyre intelektualëve dhe qytetarëve të zakonshëm të jenë dëgjuar mendime të ndryshme për shkëmbimin e territoreve, shpesh ndërsjellshëm plotësisht të mospajtueshme.


Ndër këto mendime ndërsjellshëm plotësisht të mospajtueshme mbizotërojnë, ndërkaq, mendimet e atyre institucioneve, atyre drejtuesve të partive politike, të atyre intelektualëve dhe të atyre qytetarëve të zakonshëm, që shkëmbimin e territoreve e mendojnë, duke e quajtur kundërkombëtar dhe të rrezikshëm për rajonin apo, madje, edhe më gjerë!

Nuk ka dyshim se autorët e këtyre mendimeve mbizotëruese kanë shkëmbimit të territoreve nxituan t'i shpërfillin shprehjet pothuaj mirëkuptuese ndaj lëvizjes së kufijve, domethënë ndaj shkëmbimit të territoreve mes Kosovës e Serbisë, që u dëgjuan nga figura të larta politike e shtetërore në administratën e SHBA-së e të disa vendeve të BE-së dhe në administratën e jashtë administratës së disa vendeve të tjera në botë, të cilat, ç'është e vërteta, më shpesh se mendime individuale ishin mendime zyrtare.

Nuk është e vështirë të vërehet se në deklaratimet institucionale dhe individuale për shkëmbimin e territoreve, si edhe në gjykimet tona në lidhje me çështje të mëdha kombëtare, shogjore, ekonomike e të tjera në përgjithësi, ndikim përcaktues ushtrojnë përkatësitë partiake, përkushtimet ndaj këtyre a atyre faktorëve ndërkombëtarë, përkushtimet pushtetore, formimi kulturor dhe informimi i përgjithshëm i të deklaruarve.

Çështja e shkëmbimit të territoreve mes Kosovës dhe Serbisë është çështje që, ndoshta, ndoshta mund të shtrohet në bisedimet mes shqiptarëve dhe serbëve në Bruksel dhe, si e thonë disa nga zhërguesit e tyre, mund të shtrohet në mënyrë demagogjike prej kryetarit të Serbisë, Aleksandar Vuçiq, mund të shtrohet kur e kur edhe mistifikueshëm prej kryetarit të Kosovës, Hashim Thaçi, dhe mund të shtrohet qartë prej përfaqë-

*"Të bëhet marrëveshje për kufijtë, 9 porositë e mia për një zgjidhje historike"*



Rexhep Qosja

sueses së BE-së në këto bisedime, Federika Mogherini.

Si u pa, në këtë shumësi pikëpamjesh tona për çështjen e shkëmbimit të territoreve u shprehën edhe disa paqartësi kuptimore dhe nocionore. Në një sërë rastesh çështja e shkëmbimit të territoreve u mbulua me togfjalëshit korrigjim i kufijve, lëvizje e kufijve apo, madje, dhe ndarje e Kosovës. Keqkuptim të veçantë të çështjes së shkëmbimit të territoreve përfaqëson togfjalëshi ndarje e Kosovës. Me këtë togfjalëshi në disa raste synohet zhvlerësimi i skajshëm i çështjes së shkëmbimit të territoreve, i korrigjimit të kufijve, i lëvizjes së kufijve, që në asnjë rast nuk kanë qëllimin, prandaj as kuptimin e ndarjes së Kosovës.

Të gjithë ata që sadopak e dinë historinë e çështjes së Kosovës dhe të gjithë ata që qoftë si njerëz politikë qoftë si intelektualë janë marrë dikur me këtë çështje e dinë se farkues të idesë së ndarjes së Kosovës ishte politikani dhe shkrimtari serb, Dobrica Qosja, me mirëkuptimin frymëzues të ish-ambasadorit amerikan në Beograd, Uoren Cimerman. Meqenëse Dobrica Qosja që politikantët e intelektualët serbë e synonin dhe e dëshironin ndarjen e Kosovës,

është e kuptueshme pse shkëmbimi i territoreve, atëherë prej meje dhe më vonë prej ndonjë intelektual tjetër, i shprehur me togfjalëshin nocionor lëvizje e kufirit vendor, nuk ishte dhe nuk mund të ishte ide e tyre - e serbëve në asnjë rast. Jo. Ideja e shkëmbimit të territoreve, koncepti i shkëmbimit të territoreve tashmë i ngritur në nivelin e çështjes, ishte, pra, ide e jona, e disa intelektualëve tonë, të cilët me të e mohonin idenë e ndarjes së Kosovës. Edhe me këtë ide, me idenë e shkëmbimit të territoreve atëherë në të vërtetë mbrohej ideja e tërësisë etnike dhe historike shqiptare të Kosovës me Luginën e Preshevës dhe mbrohej, sepse Kosovës i merrej territor, por dhe më shumë i bashkohej territor.

E trajtuar në shkrimet e mia disa herë edhe pas luftës, kjo çështje do sjellë reagime mospajtuuese të vrazhda, plot adhetarizëm mëhalla, sidomos pas artikullit tim të botuar në muajin janar të vitit 2017.

Nuk është e çuditshme, prandaj, pse kundër çështjes së shkëmbimit të territoreve ishin atëherë dhe janë sot bartësit e përbotuar të nacionalizmit serbo-madh: Kisha Pravoslave Serbe në Serbi, në Bosnjë e Hercegovinë, në



Kroaci, kudo në Ballkan dhe Kisha Pravoslave Serbe në SHBA, mandej intelektualët nacionalistë serbë në institucione të ndryshme të arsimit, të shkencës e të kulturës si dhe gati të gjitha partitë opozitare në Serbi.


Për idenë e shkëmbimit të territoreve sot në Serbi deklarohen kur qartë e kur mistifikueshëm kryetarit i Serbisë dhe kryetarit i Partisë më të madhe serbe, Partia Përpërmimtare Serbe, Aleksandar Vuçiq me partinë e tij, me qeverinë dhe me shumicën në Kuvendin e Serbisë. Dhe, deklarohen me shpresën se ashtu u sigurojnë përkrashjen e Bashkimit Evropian, që po i përkrash stabilokracitë autoritare në shumicën e vendeve ish komuniste, posaçërisht në Serbi e në Kosovë!

Shumësia e deklarimeve tona institucionale, partiake e individuale, kundër shkëmbimit të territoreve midis Kosovës e Serbisë në të vërtetë e tregon dëshëm s'dëshëm gjendjen e pamernduar të politikës sonë të sotme në përgjithësi. Gjendja e mosmerenduar, në të vërtetë e diletantizuar e politikës sonë shtetërore është aq shumë e përmbytur sa që kryetarit i shtetit flet për korrigjim të kufirit (pa qumimin moral që ta quajë shkëmbim të territoreve çka ai korrigjim edhe është), kurse kryeministri atë korrigjim e quan hyrje në luftë!

Në institucionet politike e shtetërore dhe në mendjet e atyre që vendosin sot në emrin e Kosovës edhe për çështje madhore siç janë bisedimet me pushtuesin njëshekullor të Kosovës me dashje a pa dashje ende nuk dihet edhe çka do të duhej të dihej, nuk bëhet e thuhet edhe çka do të duhej të bëhej e të thuhet dhe bëhet e thuhet edhe çka nuk do të duhej të bëhej e të thuhet.

Çka do të duhej të dihej në këto institucione dhe çka do të duhej të dihej prej këtyre përfaqësuesve politikë e shtetërorë të popullit shqiptar të Kosovës e, si po shihet, ende nuk dihet apo nuk shihet se dihet!

1. Do të duhej të dihej se sot midis të pushtuarit dhe pushtuesit njëshekullor, domethënë midis shqiptarëve si të pushtuar dhe serbëve si pushtues të Kosovës gjatë, kullit një shekulli, nuk bëhet dialog, por bëhen bisedime, bisedime zyrtare, shtetërore, politike e diplomatike. Për çështje madhore siç janë liria e pavarësia, siç janë kufijtë, siç është mëvetësia e shtetit nuk bëhet dialog po bëhen bisedime zyrtare, shtetërore, politike e diplomatike. E shkencore. E jo dialogë. Duke i quajtur dialog e jo



bisedime, bisedimet zyrtare, shtetërore mes shtetit të Kosovës dhe shtetit të Serbisë pjesëmarrësit e Kosovës në atë dialog në thelb po e degradojnë statusin shtetëror të Kosovës! Edhe në qoftë se një emërtim i tillë - dialog i bisedimeve u kërkohet prej jetërkujta ata nuk do të duhej ta pranojnë!

2. Do të duhej të dihej se prej Kongresit të Berlinit, në të cilin do të vendosej rend i ri botëror, para së gjithash evropian, fizionomisë politike e shtetërore të Ballkanit e përcaktontin fuqitë e mëdha evropiane: Britania e Madhe, Franca, Rusia, Gjermania, Italia. Prej Konferencës së Paqes në Paris në vitin 1919 në përcaktimin e fizionomisë politike e shtetërore të Ballkanit do të marrin pjesë me rol vendimtar edhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Gjithashtu, do të duhej të dihej se fuqitë e mëdha, varësisht prej rastit e çastit, kur më pak e kur më shumë i kanë lëvizur dhe mund t'i lëvizin parimet e kriteret në bazë të të cilave e kanë caktuar dhe mund ta caktojnë fizionominë politike e shtetërore të Ballkanit a hapësirave të tjera.

3. Fuqitë e mëdha politike dhe botërore, me institucionet e sotme botërore të mbisunduar prej tyre, tashmë gjithnjë e më shpesh të quajtura faktorë ndërkombëtarë, kur më drejtpërdrejt e kur më ndërmjetueshëm i mbikëqyrin apo, madje, i përcaktojnë bisedimet midis popujve e shteteve të konfliktuara, apo të papajtuara, që ende nuk i kanë zgjidhur të gjitha çështjet e tyre politike e shtetërore. Këta faktorë zakonisht nuk lejojnë që në bisedimet e mbikëqyrura apo, madje, të përcaktuara prej tyre njerëz palë t'i dhurohen të gjitha, kurse tjetër asgjë! Ato kur më pak e kur më shumë kujdesen, herë sipërisht e herë treqatëfytyrshëm, që ato bisedime të sjellin zgjidhje të baraspeshuara midis tyre.

4. Fuqitë e mëdha botërore, në të vërtetë faktorët ndërkombëtarë që i mbikëqyrin apo, madje, i përcaktojnë ato bisedime midis popujve e shteteve, zakonisht, nuk e kundërshtojnë fushat marrëveshjen që në mënyrë paqësore e arrijnë dy palët në bisedime dhe nuk e kundërshtojnë ashtu edhe në qoftë se ajo marrëveshje arrihet në sajë të disa zgjidhjesh që nuk janë në pajtim me ndonjë parim të politikës së tyre ndërkombëtare, siç janë, fjala vjen, korrigjimi i kufijve, lëvizja e kufijve, shkëmbimi i territoreve, apo, madje, siç ka ndodhur mes dy luftërave botërore, zhvendosja vullnetare e pjesëve të popullsisë. Veprone këshu fak-

torët ndërkombëtarë në radhë të parë për arsye se mos pajtimi me marrëveshjen që e arrijnë në mënyrë paqësore dy popuj, dy shtete, do të thotë përzierje në punët e tyre të brendshme, në të vërtetë cenim i sovranitetit të tyre politik e shtetëror, që, megjithatë, siç po shohim orë e past në Kosovë, e cenonjë me heshje e brohoritje!

5. Në bisedimet zyrtare shtetërore, politike e diplomatike midis dy popujve, dy shteteve, siç janë bisedimet e sotme midis Kosovës dhe Serbisë për çështje madhore politike e kombëtare zakonisht nuk shkohet me mendje dogmatike, nuk shkohet me një qëndrim. Në bisedimet për çështje të tilla madhore zakonisht shkohet me dy versione të të njëjtit qëndrim apo, madje, edhe me një qëndrim të quajtur alternativ. Përfaqësuesit e Kosovës në bisedimet e tanishme me përfaqësuesit e Serbisë e mohojnë pothuaj plotësisht këtë praktikë dhe e mohojnë, sepse nuk e njohin a nuk duan ta njohin përvojën e shteteve me tradita të mëdha shtetërore, diplomatike, bisedimore në përgjithësi.

6. Në bisedimet zyrtare, shtetërore, politike e diplomatike, midis popujve e shteteve, siç janë bisedimet për çështje madhore mes Kosovës dhe Serbisë, zakonisht nuk flitet me kategori folklorike e romantike dhe nuk flitet me kategori të tilla sepse ato janë kategori të fëmijërisë së kulturës politike e shtetërore. E përfaqësuesit e Kosovës në bisedimet zyrtare, shtetërore, politike, me përfaqësuesit e Serbisë dhe të shteteve të tjera ndodh të flasin pikërisht me kategori të tilla! Paraqitjet e tyre politike romantike e folklorike të shpesh të herëve përmbajnë qëllimin e mashtrimit të opinionit vendor.

Romantizmi dhe folklorizmi i tyre bëhet trumbetues posaçërisht pas cikleve të bisedimeve kur duan ta bëjnë me dije opinionin vendor për sukseset e tyre të sotme e të ardhshme bisedimore. Në raste të këtylla ata u thonë dëgjuesve të tyre se marrëveshja me Serbinë doemos do t'i sjellë Kosovës vendin në Organizatën e Kombeve të Bashkuara, thuashe pajtimi i Serbisë për t'u bërë shteti i Kosovës anëtar në OKB na qenka më i rëndësishëm se njohja prej 115 shteteve! Ata nuk e dinë apo nuk duan ta dinë se vendi i Kosovës në OKB më shumë se prej kujtdo tjetër varet prej pajtimit të Russisë dhe të Kinës, të cilat kanë të drejtën e vetos në Këshillin e Sigurimit të kësaj organizate.

Edhe me trumbetueshëm ky folklorizëm politik shprehet në

deklaratat aq shpesh të përsëritura për bashkimin e Luginës së Preshevës me Kosovën pa treguar se ky bashkim mund të realizohet vetëm duke iu dhënë Serbisë pjesë e Veriut të Kosovës me shumicën serbe. Është politikisht dhe moralisht e palajshme të mashtrohet dhe të nëncmohet mendja jonë politike me deklarata të këtylla dilatante mashtruese!

7. Në bisedimet zyrtare, shtetërore, politike e diplomatike midis popujve e shteteve, siç janë bisedimet e tanishme midis Kosovës dhe Serbisë, zakonisht duhet të njihet në tërësi jetëshkrimi politik i pjesëmarrësve, në mënyrë të veçantë, i kryepjesëmarrësit të palës tjetër në këto bisedime. Po të pajteshin me të dhënat e duhura prej fillimit të bisedimeve për jetëshkrimin politik të kryepërfaqësuesit të Serbisë në bisedime, Aleksander Vuçiqit, përfaqësuesit e Kosovës do të duhej ta "kushhtëzonin" pjesëmarrjen në bisedime me largimin e tij. Dhe, do të duhej ta "kushhtëzonin" pjesëmarrjen e tyre në bisedime me largimin e tij për shkak se ai ishte zyrtar i lartë në Partinë Radikale Serbe si parti shoviniste e Vojislav Sheshelit, për shkak se ai ishte zyrtar i lartë në qeverinë e Millosheviçit, e cila, përpos të tjerash, ka bërë dhe zhvendosjen e dhunshme të gati gjysmës së shqiptarëve të Kosovës në gjysmën e parë të vitit 1999, për shkak se ai ishte ihtar i qëndrim-

**Çështja e shkëmbimit të territoreve është çështje, çështje politike e kombëtare e madhe, sepse është çështje që i përket tërësisë territoriale të Kosovës, tërësisë territoriale të Serbisë dhe, rrjedhimisht, qëndrueshmërisë në rajon, para së gjithash në rajonin e të ashtuquajturit Ballkanit Perëndimor.**

it politik, partiak e shtetëror të Vojislav Sheshelit për dëbimin e shqiptarëve përtej Bjeshkëve të Nemuna dhe, më në fund, për shkak se ai ishte bashkëveprues politik në gjenocidin e Srebrenicës ndaj myslimanëve të Bosnjës. Mbas deklaratës zyrtare të qeverisë së Serbisë në të cilën thuhej se delegacioni serb nuk i pranonte bisedimet me delegacionin shqiptar të kryesuar prej nënkryeministrit të Kosovës, Patmir Limaj, pjesëmarrja e përfaqësuesve të Kosovës në ato bisedime me delegacionin serb të kryesuar prej Aleksander Vuçiqit bëhet plotësisht e palajshme politikisht, moralisht dhe kombëtarisht.

8. Përfaqësuesit e Kosovës në bisedimet e tanishme me përfaqësuesit e Serbisë do të duhet ta dinë se, siç na mëson historia, asnjë rend botëror s'është i gjithmonshëm: çdo rend botëror më herët a më vonë zëvendësohet prej një rendi tjetër botëror. Rendi i sotëm botëror, i bazuar në të drejtat e njeriut, është rend botëror si i dhuarar prej Perëndisë për në shqiptarët.

Por nuk do të duhej të harrojmë se edhe ky rend botëror do të ketë një fund dhe dikur do të jetë i zëvendësuar prej një rendi tjetër botëror. Mjerisht askush prej nesh sot s'mund ta thotë me siguri nëse ai rend tjetër botëror do të jetë i fatshëm a fatkeq për ne. Por ne, si popull, si popull tani me dy shtete nuk guxojmë të mos mendojmë edhe për këtë mundësi të dytë.

9. Përfaqësuesit e Kosovës në bisedimet e tanishme me përfaqësuesit e Serbisë do të duhej të dinë se edhe më tej, shumë, shumë serbë, në të vërtetë, numri më i madh i tyre, besojnë në mitologjinë mesjetare serbe. Ata besojnë se historia e Kishës Pravoslave Serbe në Kosovë është histori 800-vjeçare! Ata besojnë se Prizreni ishte kryeqyteti i Perandorisë së Car Dushanit! Ata besojnë se Kosova është burimi shpirtëror i serbëve! Ata besojnë se Kosova me historinë dhe traditën e saj përcakton identitetin shpirtëror serb! Kjo pseudomitologji është përmbajtje e shkrimeve të një vargu studiuesish, shkrimtarësh e intelektualësh të tjerë serbë sot, që kundërshtojnë me gjuhë goja shkencore, në të vërtetë euforike, çdo ide për pajtimin me shkëmbim territoresh e me pavarësinë e Kosovës. Ata e përsërisin mendimin e kryetarit të dikurshëm grek Karamanlis, i cili në një rast i paska thenë Dobrica Posiqit: "Asgjë s'mund të bëni sot për Kosovën, sepse të gjithë janë kundër jush: duhet të prisni kohë tjetër që doemos do të vijë!"

Mund të supozohet se informimi i përfaqësuesve të Kosovës në bisedimet zyrtare, shtetërore, politike e diplomatike, me përfaqësuesit e Serbisë në Bruksel për idetë dhe domethëniet politike, diplomatike, shtetërore të përmbajtura në pikat e sipërthëna nuk do të ishte i pafrtytshëm për ta. Nuk ka dyshim se shpjegimet e sipërthëna sjellin bindjen se shkëmbimi i territoreve s'do parë e trajtuar siç po e trajtojnë kundërshtarët e tij.

Nuk e quaj mençuri zgjidhjen e hamendësuar të konfliktit të gjatë historik shqiptar-serb me arnime të përkohshme! E quaj mençuri politike e historike zgjidhjen e këtij konflikti me zgjidhje të përhershme, me zgjidhje historike, që nënkuptojnë shkëmbimi i territoreve, i shfaqur si gjasë pothuaj e papritur sot, për brezin tonë.

Dijet që janë mbledhur në mendimorën tonë kombëtare për historinë e çështjes së Kosovës dhe çështjes shqiptare në përgjithësi, dijet që janë mbledhur në mendimorën tonë kombëtare për historinë e Serbisë e për pseudomitologjinë e saj mesjetare që, megjithatë, përbën përqaktuesin e gjendjes shpirtërore e kulturore serbe, dijet që do të duhej të kishim për rolin e Kishës Pravoslave Serbe në politikën dhe në jetën kombëtare, shtetërore, politike e kulturore serbe gjatë historisë e sot dhe, pashmangshëm, mendimet e pandalshme që ne, brezi i sotëm, duhet t'i kemi për ardhmërinë e qetë dhe të sigurt të pasardhësve tonë, pa dhembjet e tragjeditë tona të deritanishme - të gjitha këto më bëjnë të besoj se shkëmbimi i territoreve: i Veriut të Mitrovicës, natyrisht, pa objekt vitalë për zhvillimin e Kosovës, me Luginën e Preshevës (Presheve, Bujanoc e Medvegje) do të ishte zgjidhja politike, shtetërore e kombëtare, domethënë do të ishte zgjidhja historike e çështjes së marrëdhënive të Kosovës me Serbinë.

Të përsëris, brezi ynë i sotëm s'ka të drejtë morale të mendojë për përfundimin e bisedimeve me Serbinë pa menduar për ardhmërinë e pasardhësve tonë. E do

të mendojmë si duhet për ardhmërinë e pasardhësve tonë në qoftë se do ta kemi në mendje atë urtësinë e mendimtarit të madh evropian i cili ka thenë: "Shteti është bashkëpronë e të gjallëve, e të vdekurve dhe e të palindurve ende". Domethënë: Shteti është i atyre që kanë jetuar, por nuk janë më të gjallë, i atyre që sot jetojnë në të dhe i atyre që do të jetojnë pas nesh në të, domethënë i pasardhësve tonë.

Tradita politike e historike jo vetëm evropiane dhe mendimi i menduar historik, objektiv, na thonë se nuk është shkëmbimi i territoreve, në këtë mes i territoreve të sipërthënë, i arritur në mënyrë paqësore, me marrëveshje midis dy palëve, çështje që sjell luftë. Jo. Dhe, jo. Marrëveshjet paqësore, që arrihen me marrëveshje midis palëve në konflikt apo ende të papajtuara, nuk sjellin luftë; luftë mund të sjellin marrëveshjet e pranura nën trysninë nën trysninë e faktorëve të brendshëm apo të jashtëm.

Shkëmbimi i territoreve të sipërthëna midis Kosovës dhe Serbisë do të mënjanojnë prej së tashme së Kosovës të gjitha ato kërkesa dhe pengesa të Serbisë dhe të strukturave serbe në Kosovë, që po e pengojnë Kosovën të bëhet shtet funksional.

Shkëmbimi i territoreve të sipërthëna do të mënjanojnë prej historisë së Kosovës dhe historisë shqiptare në përgjithësi të papritur e mundshme, kur më pak e kur më shumë kundërvepëruese, që përmban Bashkësinë e Komunesë Serbe në Kosovë, që me politikën dhe me veprimtarinë e saj, të paraparë e të paparaparrë, përbën faktorin e forcimit të rolit të serbëve në Kosovë, e përmes tyre të forcimit të rolit politik edhe të Serbisë në Kosovë e në rajon - të forcimit me përberje e qëllime të paparashikueshme prej strukturave politike e shtetërore të Kosovës sot!

Rrjedhimisht shkëmbimi i territoreve në mënyrë paqësore, me Marrëveshje, midis Kosovës dhe Serbisë mund të shpeshohet, e përsëris, mund të shpeshohet, sado kurrë me siguri të qindpërqind, se sjell paqe midis këtyre shteteve dhe popujve të tyre, paqe të përthame dhe paqe historike. Marrëveshja e tillë, e realizuar me shkëmbim të territoreve, realisht do të duhej ta bënte të pamundshme, me të gjitha pikëpamjet të pamundshme, rilindjen, në të vërtetë vampirizimin e pasojave të pseudomitologjisë serbe në Kosovë. Kjo, ndërkaq, nuk mund të thuhet për marrëveshje të tjera, të arritura me arnime, me pajtime e çpajtime të tjera!

Nuk mund të mos supozohet sadoqap, ndërkaq, se roli i tillë historik i shkëmbimit të territoreve e ka shtuar numrin e zyrtarëve të sotëm dhe të mëparshëm politikë e shtetërorë në SHBA-të dhe në BE-në dhe në disa vende të tjera, që janë shprehur në favor të shkëmbimit të territoreve mes Kosovës e Serbisë.

Dhe, në fund, le të thuhet haptas e qartë edhe ky mendim që mund t'i hidhërojë feudalët politikë e intelektualë në Kosovë sot.

Shkëmbimi i territoreve të sipërthëna, i arritur në paqe, me Marrëveshje midis shqiptarëve dhe serbëve, me pajtimin në fund të faktorëve ndërkombëtarë, me pajtimin e SHBA-së dhe të BE-së, do ta bënte më të madhe se ç'është sot mundësinë politike, kombëtare e ndërkombëtare, për zgjidhjen përfundimtare, historike, të çështjes së Kosovës: për Bashkimin e Kosovës me Shqipërinë.

Ashtu qoftë!

Opinion *i* Ditës

# Integrimi ekonomik Kosovë-Shqipëri, si patriotizëm prej vërteti

Nga Fatos Çoçoli

(vijon nga faqja 1)

.... 10 vite e gjysmë pritshmëri dhe ndjeshmëri e lartë e shqiptarëve nga të dyja anët e kufirit, sidomos e sipërmarrjeve, për unifikimin e procedurave doganore mes të dyja vendeve tona. Kësaj shprese nuk i është përgjigjur askush seriozisht si nga Tirana, ashtu edhe nga Prishtina. Nuk është as tabu, as sakrilegj të flasësh për bashkim doganor. Unifikimi doganor është vetëm një nga elementët e Procesit të Berlinit. E rrugëtimit të integrimit ekonomik ndërmjet shteteve të Ballkanit Jugperëndimor.

Ai përbën një prelude, një parapërgatitje të një bashkimi doganor me BE-në. Samiti i Triestes, i mbajtur në 12 korrik 2017, vuri theksin tek angazhimi i përbashkët për të afruar më tej vendet e Ballkanit Perëndimor me Bashkimin Europian, nëpërmjet nismave si "Zona Ekonomike Rajonale" dhe Traktati i Komunitetit të Transportit, si etapa e radhës e Procesit të Berlinit, në vazhdim të samiteve të organizuara në Berlin (2014), Vjenë (2015) dhe Paris (2016). Në këtë samit, 6 vendet e Ballkanit Jugperëndimor, përfshirë edhe Kosovën dhe Shqipërinë, miratuan Planin e Veprimit Shumëvjeçar për një Zonë Ekonomike Rajonale në Ballkanin Perëndimor. Krijimi i Zonës Ekonomike Rajonale nuk është një karshillëk apo alternativë ndaj Bashkimit Europian, por një angazhim i përbashkët për të plotësuar Kriterin Ekonomik të Kopenhagenit, që të integrohem më mirë dhe më shpejt me BE-në. Bashkimi Evropian është finacues i pikës së përbashkët doganore në Morinë-Vërmicë.

Edhe ai ka pritshmëri të lartë për të parë tek Shqipëria një ekonomi të fortë, me protagonizëm rajonal dhe institucionalisht të pjekur për t'u bashkuar me tregun e përbashkët evropian. Lind pyetja: si iu përgjigjëm ne si qeveri kësaj klime pozitive bashkimi ekonomik? Duke bërë praktikisht asgjë konkrete. KLSH, në një auditim të performancës, të zhvilluar këtë vit është përpjekur t'i japë përgjigje pyetjes: "A ka qenë efektive veprimtaria e autoriteteve



tona shtetërore (të Shqipërisë) në drejtim të unifikimit të pikave doganore me Kosovën?" Dhe ka gjetur se marrëveshjet e nënshkuara mes dy qeverive dhe ministrive përkatëse janë vetëm dhe thjesht një formë e shprehjes së vullnetit të mirë. Ato nuk janë shndërruar në politika të mirëfillta qeveritare, në strategji, plan veprimi e masa që të realizonin me përgjegjshmëri dhe me sukses bashkimin doganor me Kosovën.

Nuk ka një strategji të posaçme për unifikimin doganor me Kosovën. Dhe mungesa e këtij interesi konkret dhe vijmësie në veprime, përtej fjalëve të bukura, ka dëmtonar dukshëm besimin e bizneseve në dy anët e kufirit. Deri më sot, veprimtaria e Ministrisë sonë të Financave e Ekonomisë dhe e Drejtorisë së Përgjithshme të Doga-

nave në unifikimin e pikave doganore është e mangët si proces teknik. Ajo nuk ka krijuar kushtet për një bashkim doganor të shpejtë ndërmjet Shqipërisë dhe Kosovës. Nuk është hedhur hapi vendimtar, unifikimi i politikave fiskale, si parakusht për sigurimin e bashkimit doganor. Ende mes Shqipërisë dhe Kosovës nuk ekziston një kuadër rregullator i posaçëm, që të rregullojë marrëdhëniet mes dy vendeve, por vihet re një kuadër i shpërndarë në dispozitat e morive të marrëveshjeve të nënshkuara. Këto marrëveshje e cekin në mënyrë tangente unifikimin e pikave doganore me Kosovën. Ato nuk përfaqësojnë në thelb, formë e përmbajtje, një bazë ligjore të posaçme për zbatim.

Nga mbledhjet e shumta mes të

dyja qeverive është përmendur hapja e pikës doganore të Kosovës në Portin e Durrësit që në fund të vitit 2016. Është për t'u përsëritur vendimi i orëve të fundit i qeverisë sonë për t'i mundësuar Zyrës Doganore të Republikës së Kosovës që të kryejë procedura doganore në Portin e Durrësit dhe në Porto-Romano, veçse sa mirë që u kujtua, se u deshën gati dy vjet, që nga ngritja e grupit të posaçëm të punës në janar 2017 për pikën doganore kosovare në Durrës, që më në fund të miratonte këtë vendim të thjeshtë. Është një dallëndyshe e mirë, edhe pse e vonuar, për bashkimin doganor mes Shqipërisë dhe Kosovës. Dhe ky bashkim nuk është thjesht retorikë patriotike. Dobitë ekonomike të tij janë të qarta dhe të mëdha.

Unifikimi i pikave doganore do të rrisë fluksin e shkëmbimit të mallrave midis dy vendeve, do të nxisë sipërmarrjen e lirë, do të ulë kostot për bizneset si dhe do të rrisë potencialet për thithjen e investimeve të huaja, etj. Në lëmin administrativ, do të ulë kostot administrative e do të rrisë eficientën dhe efektivitetin e administratës, përmes kontrolleve të përbashkëta doganore, shkëmbimit të informacionit në kohë reale, analizës së përbashkët të riskut, duke sjellë një menaxhim më të mirë të mbledhjes së të ardhurave doganore dhe forcimin e luftës ndaj kontrabandës dhe korrupsionit. Ja përse na duhet bashkimi doganor si patriotizëm prej vërteti, për të përfutur nga hapja e tregjeve tona. Më mirë vonë, se kurrë, thotë populli.

## BalkanWeb.com

AGJENCIA E LAJMEVE MË E KLIKUAR NË HAPËSIRËN SHQIPTARE.  
LAJMET MË TË FUNDIT ME VIDEO DHE FOTO NGA VENDNGJARJA,  
ANALIZA DHE TEMATIKA TË NDRYSHME, GJITHÇKA ME NJË KLIKIM.

INSTALONI APLIKACIONIN E BALKANWEB  
NE MOBILE DHE TABLET

KERKONI NE APPLE STORE DHE GOOGLE  
PLAY OSE DUKE SKANUAR QR CODE  
APPLE DHE ANDROID



Opinion *i* Ditës

# Regjisori i dy qeverive

Nga Andi Bushati

(vijon nga faqja 1)

... të Shqipërisë dhe Kosovës, ai e demonstroi me shembuj se kjo është e vërtetë. I vuri në resht të gjithë ministrat, me një skenografi të menduar që më parë, të pozonin së bashku me shqiponjën mbi gjoks. E bëri Ramush Haradinajn të nënshkruante mbi flamurin kombëtar dhe sikur kjo të mos mjaftonte, me një akt viril alla Trump, e tërhoqi me forcë krahu prej ish-badigardi të homologut të tij, për ta theksuar se, ai dhe vetëm ai, regjisori i kësaj mizanskene.

Të gjitha këto imazhe të ekzagjeruara ku është e vështirë të përcaktohet kufiri i hollë mes nacionalistit dhe patriotit qenë veshja simbolike e asaj që kryeministri shqiptar do të ligjëronte me gojë. Ai hapi për të disatën herë temën e bashkimit kombëtar, por duke hedhur një hap më përpara, kërkoi një përgatitje institucionale të diplomacisë së dy vendeve për këtë objektivi dhe vendosi edhe një afat skandence: 2025-ën.

Natyrisht, ashtu sikurse ndodh në raste të ngjashme me të gjithë liderët shqiptarë edhe këtë herë nuk do të mungojnë komentet se Rama po vesh kostumin e nacionalizmit për të hequr vëmendjen nga problemet e brendshme, apo se po flet për bashkim kombëtar për të shantazhuar ato qarqe perëndimore që kanë filluar denoncimin e pushtetit të tij kriminal dhe të korrumpuar.

Por, këtë radhë, problemi nuk është vetëm tek këto mëkate që i janë mveshur njëri pas tjetrit Berishës së parë, Fatos Nanos dhe Berishës së dytë.

E reja është se Rama po shton dozat anti europiane. Në optikën e deklaratave të kësaj të hënë është refuzimi i Brukselit që po detyron dy shtetet shqiptare të shkojnë drejt një projekti të përbashkët për 2025.

Sipas fjalëve të tij, fakti se BE, i premtoi kosovarëve lëvizjen e lirë dhe nuk ia dha (megjithëse ata e firmosën demarkacionin), fakti se Brukseli po përkëdhel më shumë sesa duhet Serbinë, fakti tjetër se frika nga ekstremi i djathtë po pengon përparimin e Shqipërisë, i detyron dy vendet të hedhin këtë hap.

Dhe pikërisht këtu kemi një ndryshim thelbësor të njërit prej akteve më të rëndësishëm të politikës sonë të jashtme.

Nëse deri dje, të gjitha forcat serioze politike të vendit i përmbaheshin tezës "bashkim, brenda BE", sot Rama po përpunon idenë: "bashkim si kundërvënje ndaj BE-së", pra një lloj sfide ndaj indiferencës, injorimit dhe refuzimit që po tregon Brukseli.

Ndoshta as deri këtu nuk ka ndonjë mëkat të madh. Sado të ketë brohoritur pro Europës, një komb i ndarë si i yni, nuk ka pse të mos ketë një plan B, aq më tepër sot që po flitet gjithnjë e më shumë për krizën e BE dhe të ç'integritimit të mundshëm të saj.



Por, mëkati i Ramës nuk është ky. Nuk është as vizioni për të përpunuar një të ardhme alternative dhe as ai për të përafuruar aksionin e dy qeverive me një qëllim kombëtar të përbashkët.

Loja e tij djallëzore konsiston në paraqitjen e situatës bardhë e zi.

Ai fajëson vetëm Brukselin, burokratët e tij, ankthin e tyre nga ekstremistët ksenofobë dhe kompleksët ndaj Serbisë për mospërparimin drejt BE-së të dy pjesëve të ndara të kombit. Në gjysmën e gotës që sheh bosh, ai nuk thotë asnjë fjalë për shtetin jo funksional të Kosovës, për një shoqëri që nuk

e ka kapërcyer dot sindromën e komandantëve të luftës, për një qeverisje të zhytur në krim dhe korrupsion, pa aq sa dhe kjo jona.

Përpos problemeve të vetë Europës janë edhe mëkatet tona - ndoshta edhe më të mëdha - që na bëjnë të mos avancojmë drejt saj. Por, këtë anë të medaljes Edi Rama refuzon ta shikojë. Ai e fsheh atë në mënyrë të ndërgjegjshme, duke bërë që në dyzimin e kahmotshëm mes patriotëve, që luftojnë për vendin e tyre real dhe nacionalistëve që tentojnë të luajnë me emocionet e kombit të tyre virtual, ai të renditet me të dytë.

Pikërisht, nga që nuk përballat

dot me tërë realitetin e hidhur, Rama tenton ta fshehë gjysmën e tij. Ai i paraqet shqiptarët si viktimë dhe Europën si të padrejtë. Dhe kur argumentet për këtë i mungojnë, kur e ndjen se ligjërimi i tij për BE-në si faktor i vetëm, nuk është bindës, atë që lë mangët logjika ai mëton ta mbushë me simbole.

Prandaj, këtë të hënë, veç fjalëve, ai u rek ta mbushë takimin e Pejës plot foto me shqiponja dhe autografe mbi flamurë, duke besuar se atë që nuk arrin ta bëjë dot një politikan i keq, mund ta plotësojë një regjisor i mirë.

Lapsi.al

## HOROSKOPI

### DASHI

Për ju kjo ditë do jetë e qetë. Nëse tregoheni të logjikshëm dhe të duruar, nuk do hasni probleme. Në dashuri priten zhvillime të rëndësishme, sidomos për beqarët. Kështu që ata duhet t'i bëjnë sytë katër!

### DEMI

Nëse synoni që gjërat t'ju ecin sa më mirë sot, duhet të jeni më tolerantë dhe duhet të komunikoni më shumë me ata që iu rrethojnë. Në momente ankthi duhet të mësoni të ruani qetësinë.

### BINJAKET

Gjatë ditës, mbështetja e të afërmeve do jetë e madhe dhe kjo do t'ju ndihmojë të arrini atë që doni. Për sa i përket dashurisë, do ndjeni pak vetmi, por më pas gjërat do rregullohen. Në punë gjërat duken stabile.

### GAFORJA

Keni shumë ide dhe projekte në mendje, por duhet t'i mendoni me kujdes para se t'i vini në zbatim. Ju të dashuruarit do prisni shumë nga personi që doni, por nuk do merrni mjaftueshëm.

### LUANI

Kjo do të jetë një ditë dinamike dhe shumë kreative. Në përgjithësi do keni arritje të vazhdueshme. Duke qenë se do jeni shumë të shqetësuar për shoqërinë, do e lini pak pas dore dashurinë.

### VIRGJERESHA

Në përgjithësi ambienti rreth jush tuaj do jetë i ngrohtë. Edhe problemet e vogla që mund t'iu dalin, do i kaloni pa problem. Për dashurinë do jetë një periudhë shumë e këndshme. Do ndjeheni shumë mirë pranë partnerit.

### PESHORJA

Fillimi i ditës do jetë goxha pozitiv, kështu që përfitoni për të ndrequr disa gabime të bëra. Shëndeti nuk ka për të qenë në periudhën më të mirë. Do jeni pak të stresuar dhe të lodhur.

### AKREPI

Nëse nuk doni të përballeni me probleme gjatë kësaj dite, tregohuni të vëmendshëm dhe bëni kujdes nga intrigat. Jo të gjithë do mendojnë atë që do ju shprehin në sy. Në dashuri gjërat do shkojnë mirë.

### SHIGJETARI

Humori juaj do të ndryshojë shpesh gjatë kësaj dite dhe nuk do jetë e lehtë për t'u kuptuar. Ndonjëherë mund të fiksoheni edhe pas disa gjërave të vogla pa asnjë vlerë dhe do i doni me patjetër.

### BRICJAPI

Morali juaj që ishte plotësisht i rënë sot do të përmirësohet. Do jeni më optimist për çdo gjë dhe nuk do dorëzoheni lehtë. Në jetën në çift mund të keni disa probleme të vogla. Kalojeni me qetësi.

### UJORI

Kjo ditë do të jetë me shumë angazhime për ju. Edhe pse mund të merrni kritika dhe mund të kaloni pengesa, asgjë dhe askush nuk do ju ndalë të bëni atë që dëshironi. Familjen do e keni mbështetje dhe frymëzim.

### PESHQIT

Komunikimi i mirë do ju ndihmojë të kaloni edhe sfidat më të vështira gjatë kësaj dite. Të gjithë do ju dëgjojnë me kujdes dhe do marrin shembull prej jush. Çështjet e dashurisë kanë nevojë për vëmendje.

"FANATICS" BOJKOTOJNË DERBIN

Derbi i madh i kryeqytetit nuk do të jetë i plotë. Fatkeqësisht "Tirona Fanatics" kanë vendosur ta bojkotojnë këtë sfidë, pasi siç deklarojnë vetë, nuk mund të shkojnë si tifozëri pritëse në stadiumin e tyre. Konflikti mes tifozërisë së organizuar bardheblu dhe



presidentit Refik Halili, ka nisur dy sezona më parë, kur Halili pranoi të nënshkruante me homologun e tij të Partizanit, të drejtën për shfrytëzimin e impiantit që është pronë e Bashkisë së Tiranës, aksionere në klubin bardheblu. "Tifogrupi "Tirona Fanatics" nuk do të jetë prezent të premtën në ndeshjen e radhës kundër "pjellës së

Ultrasit bardheblu: Miq në shtëpinë tonë? Le të shkojë Halili

Beogradit"! Tifozët e Tironës kurrë nuk mund të jenë miq në shtëpinë e tyre, pavarësisht çdo lloj situatë. Refik Halili bashkë me qiraxhinjtë e tij mund të vazhdojnë të luajnë "e ka kush e ka" për vendet e stadiumit, ama intelekti i

tifozëve bardheblu qëndron shumë shkallë lart tyre... Tirona është më shumë se një ndeshje, 90 minuta apo një derbi artificial. Tirona është më shumë se futbolli!", lexohet në komunikatën e ultrasve bardheblu.

DEBATI ME TIFOZET

Disiplina gjobit Lorenc Trashin me 50 mijë lekë

Komisioni i Disiplinës në FSHF ka publikuar masat e marra për atë çfarë ka ndodhur fundjavën që shkoi në të gjitha kategoritë e futbollit shqiptar: Mesfushori i Partizanit, Lorenc Trashit, është dënuar me 50 mijë lekë të reja gjobë për sjelljen e gabuar në stadiumin e Vlorës gjatë ndeshjes Flamurtari-Partizani. Kështu, ai nuk do të mungojë në derbin me Tiranën. Janë dhënë dënime të shumta edhe për kategoritë inferiore, por edhe për ekipet e të rinjë, për ekipe dhe individë. Bie në sy gjoba e majme e Kukësit U-19, 10 milionë lekë gjobë, për shkak të tifozët e tij u futën në fushën e lojës gjatë ndeshjes me Kastriotin U-19. Një gjobë rekord kjo, por që sipas rregullores për ekipet e moshave, mund të paguhet me 3%.



Jeton Selimi

Kartonët janë një çështje delikate, por Bruno po tregon kujdes që mos të humbasë asnjë ndeshje

Telushi: Flamurtarin e lamë pas, fitojmë derbin për tifozët

Mesfushori vlonjzat karikon skuadrën para Tiranës

Partizani-Tirana është sfida më e zjarrtë e futbollit shqiptar. Derbi i madh i kryeqytetit është përplasja më interesante e javës së 15-të, ndërsa si të kuqtë, ashtu edhe bardheblutë, kërkojnë medeos fitoren, fitore që më shumë sesa tre pikët, vlen për prestigjin. Partizani përgatitet për këtë 90 minutësh pas humbjes së pësuar në Vlorë ndaj Flamurtarit, ndërsa mesfushori Bruno Telushi, që në këtë edicion futbollistik luan derbet e para në karrierë, kërkon medeos suksesin, sukses që jo vetëm do t'u lejojte të kupte të ruanin vendin e parë në renditje, por ta çonin në 15 serinë e ndeshjeve pa humbje në sfidën më të rëndësishme për të dyja tifozërit. "Derbi është maja e futbollit shqiptar dhe po mendohe mi të përgatitemi sa më mirë. Uroj të bëjmë atë që duhet dhe ta fitojmë këtë ndeshje. Transferata e Vlorës ishte një ndeshje për t'u harruar dhe duhet të reagojmë. Kam shumë besim se Partizani do të reagojë, siç ka bërë edhe pas humbjeve me



Skënderbeun. Forca e grupit ka bërë që të ruajmë vendin e parë dhe të mbajmë këtë ritëm," deklar

aron Telushi, që shikon të sfida e radhës mundësinë për të shkundur dhe njëherë ambientin pas dis-

fatës 1-0 të së premtës së shkuar. Gjithashtu, një tjetër shqetësim kanë qenë kartonët, me Te-

lushin, që ndonëse njihet si një luftëtar në fushë, kësaj radhe po bën çmos që të mos humbasë asnjë ndeshje. "Edhe shokët më pyesin: pse kaq butë? Pas kartonit të tretë jam ruajtur të mos marr karton. E kam pasur shumë të vështirë, pasi forca ime është karakteri i fortë. Po mendoj për derbin që prej 7-8 ndeshjesh dhe uroj të mos ndëshkohem as ndaj Tiranës. Edhe po shënova nuk besoj se do të shkoj deri aty sa të marr karton për festën e golit". Në fund dy fjalë dhe për tifozët, që derbin e kanë motiv krenarie. "Tifozët janë lojtarë i 12-të dhe derbi është një ndeshje, ku spektakli nuk duhet të mungojë. Stadiumi duhet të jetë plot me tifozë, të cilët duhet të na përkrahin," thotë Telushi.

Mbrojtësi i Skënderbeut

Ofertë nga Astana dhe Karabaku për Fidan Alitin

Skënderbeu është kthyer në një skuadër që po e shfrytëzon marketingun dhe një nga klubet që po u jep përparësi elementeve të rinj të talentuar nga Shqipëria dhe jo vetëm. Shitjet e Olaimkës apo dhe Latifit, të cilësuar si ndër talentet më të mëdhenj që ka pasur klubi korçar apo dhe Superiorja janë kanë bërë jo pak bujë. Por, korçarët duket se po përgatiten që të kenë të tjera shitje, e madje bëhet fjalë për lojtarë cilësorë dhe titullarë që po spikatin këtë sezon. Një ndër lojtarët që mund të largohet është mbrojtësi i qendrës që luan edhe me përfaqësuesen e Kosovës. Bëhet fjalë për mbrojtësin shtatlartë Fidan Aliti, 25-vjeçar, nga më të spikatur në Korçë dhe që është pjesë e përfaqësueses së Kosovës. Aliti luan sezonin e tij të dytë me bardhekuqtë dhe ka treguar një performancë në rritje. Ofertat për të nuk kanë munguar që më verën e shkuar, por aktivizimi i këtij sezoni duket se ja ka rritur edhe më shumë emimin e kartonit. "Vipsport.al" ka mësuar se janë dy skuadra të njohura, Astana e Kazakistanit, e cila luan rregullisht edhe në Kupat e Evropës, por edhe Karabak i Azerbajxhanit, janë dy nga ekipet që janë të interesuar për mbrojtësin shtatlartë. Me shumë gjasë, kush do të ofrojë më shumë do e bëjë të vetin Alitin që tashmë është në kulmin e karrierës.

SONDAZHI NË ITALI

Juventus, skuadra më e dashur, Interi më e urryera

Në sondazhin e kryen në Itali nga "European Football Benchmark" kanë marrë pjesë 34 milionë persona. nga të cilët 19 milionë ishin popullsi mbi 18 vjeç. Sondazhi kishte të bënte me numrin e skuadrës më të pëlqyer në Itali dhe asaj më të urryerës. Juventus është konfirmuar si skuadra më shumë tifozë duke marrë shumicën e votave. Bardhezinjët ndiqen nga Milani me 19% dhe Interi po me këtë kuotë. Për sa i përket skuadrës më të urryer e kryeson Interi me 40% duke u ndjekur nga Juventus dhe Milani. Një



sondazh është bërë edhe për ekipet më simpatike ku befasia është se kryeson Fiorentina me 30%. Më poshtë edhe tabela e plotë e për-

SKUADRAT MË TË PËLQYERA	
1- Juventus	39%
2- Milani	19%
3- Interi	19%
4- Napoli	15%
5- Roma	13%
Skuadrat më simpatike	
1- Fiorentina	30%
2- Atalanta	27%
3- Roma	24%
4- Napoli	22%
5- Lacio	21%
Skuadrat më të urryera	
1- Interi	40%
2- Juventus	38%
3- Milani	32%
4- Napoli	30%
5- Lacio	26%


Incidenti përpara ndeshjes me Monakon

Sulmoi me bombë Borussia, dënohet me 14 vite burg agresori

Më 11 prill të vitit të kaluar, para ndeshjes me Monakon, autobusi i Borussia së Dortmundit u sulmua dhe të plagosur mbetën mbrojtësi Mark Bartra dhe një polic. Tashmë gjykata ka dhënë dënimin për agresorin, i cili duhet të bëjë 14 vite burg. Bëhet fjalë për Sergej Venergod, një 29-vjeçar që është shpallur fajtor për ngjarjen në fjalë, pasi ishte akuzuar për tentative vrasjeje. Sipas gjykatës, objektivi i Venergod ishte që ta sulmonte skuadrën verdeze për të përfutur më pas nga rënia e mundshme e aksioneve të klubit. Më 11 prill të vitit 2017 ai kishte hedhur tre bomba në drejtim të autobusit të Borussia gjatë rrugës për në stadium. Mbrojtësi Bartra dhe një polic mbetën të plagosur nga shpërthimet.



**Fjalëkryqi (1)**



**HORIZONTAL**

1. E famshmja Curie
5. Më e mira është rekord.
9. Inicialet e Kurosawa-s.
11. Eshhtë edhe ai i mendimeve.
12. Një mund të jetë zemërkau
13. Eshhtë dollapi.
14. Gjysmë mizoze.
15. Fillojnë sefte.
16. Ishte shkollë e Aristotelit.
20. Ndodh në kufij.
22. Bëhen me ambalazh.
23. Janë idhnakë.
25. Fillojnë titujt.
26. Do të bëhen pemë.
27. Ashtu si jeton heremit.
29. Eshhtë dhomë e lartë.
30. Janë spanjollët dhe portugezët.
32. Ishte filozofi që preu damarët.

34. Janë gjuhë...veshi.
35. Musketierët e Dumas.
36. Lila këngëtare.
37. Kufizojnë takimet.
38. Ullmann aktore.
39. Mbledh baskët separatistë.
40. Fillojnë kapjen.
41. Inicialet e Delon.
43. Lumi i Bernës.
44. Eshhtë numri të parit.
45. Një thirrje me emra.

**VERTIKAL**

1. Farrow aktore.
2. Me Romeo në makinë.
3. Rolet pa zë.
4. Kufij itinerari.
5. Ai ekzekutiv u bë bashki.
6. Në mes të dhomës.
7. Një tabu islamike
8. Mbyllin fushatat.
10. Janë festime
11. Lehar kompozitor.
12. Janë shtyllat për vela
14. Ata të Ferrari-t qëndrojnë në box.
16. Duhet fituar me djerse.
17. Piktura pa kura.
18. Janë dokumente partie.
19. Në fund të vitit.
21. Farkëtoi armët e Akilit.
22. Një është për kërcim.
24. Athinaja e romakëve.
25. Janë kapriçiot.
27. Një tis mjegulle.
28. Kërcimi i Fred Astaire.
31. Edwards regjisor.
33. Parker regjisor.
38. Luan në kufij
39. Inicialet e Rohmer.
42. Fillojnë detyrën.


**Fjalëkryqi (2)**

**HORIZONTAL**


1. Lama i Tloetit.
5. Janë vendet e lira
11. Martin i Jack London.
13. Comaneci e famshme e gjimnastikës.
15. Ekstremit në sirtar.
16. Janë princë arabë.
17. Një treshe në skenë.
19. Një provë inteligjence.
21. Gjysmë tatimi.
23. Gjysmë eolike.
24. Ekstremit në studim.
25. Bëjnë stil të lirë
28. Ndalo në kufij
29. Kaluar në krye.
30. Një tragjedi... e Dreiser.
33. Grier aktore.
34. Dashi kur mungon ai
36. Eshhtë zanore në filma
38. Kufizohet në kufij
39. Entë Civile Europiane.

**VERTIKAL**


1. Eshhtë halli.
2. Fillon me rruga...
3. Kastile janë në fund
4. Janë në skaje
6. Eshhtë vendi aderues
7. Ka kryeqytet Doha.
8. Inicialet e Daudet.
9. Ndërmarrje Industriale Tiranë.
10. Iglit te Lazio.
12. Janë zjarrvënës.
14. Flanders e Defoe.
18. Shkroi Rinoceronti.
20. Ekstremit në slam.
22. Janë trille.
25. Qytet italian.
26. Jepen për hartim.
27. Fillojë takimet.
29. Kufizojnë kënde.
31. Janë vendet e para.
32. Një greminë.
35. Eshhtë logarim që qërohet.
36. Ndëron me ilace.
37. Massari aktore italiane.
38. Eshhtë melodramë.
40. Një thirrje e dëshiruar nga maja e direktor.
41. Kush ka... fërgëllon.
44. Një i fundit mbi të gjithë.
45. Një pjesë e satelitëve.
47. Në krye të njerëzve.
48. Sikur janë në krye.
49. Inicialet e Taylor që qe aktore..



**Gjeni ndryshimin**



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

**PËRGJIGJET E FJALËKRYQEVE TË NUMRIT TË KALUAR**

M	A	T	I	S	S	E	K	A	L	A	T	E
I	R	O	N	H	B	I	D	O	N	E	T	
A	O	P	E	R	A	A	L	E	T	I		
S	T	E	A	N	A	T	E	M	A	T		
K	P	E	L	I	K	A	N	I	A	T	A	
E	P	I	D	E	M	I	K	E	A	R	E	S
D	O	R	O	T	E	A	L	B	E	R	T	
I	L	L	M	T	M	I	E	T	I	A		
N	A	S	S	P	A	R	O	T	I	S	R	
A	K	T	U	A	L	I	T	E	T	I	A	
T	E	A	M	E	R	T	M	E	R	R		
T	R	A	G	E	T	I	A	I	D	A	N	
A	V	A	B	B	A	A	L	M	A			
P	U	A	M	A	R	E	T	A	T	A	R	
E	S	F	E	R	A	T	N	O	R	A		
L	A	T	L	I	P	O	T	I	M	I	A	
M	O	N	O	T	O	N	E	T	R	I	T	
S	A	L	D	O	R	R	A	O	N	E		
E	T	I	N	T	E	R	U	N	I	I		
N	O	T	I	E	I	T	I	N	K	P		
D	R	E	R	E	I	A	O	M	E	R	A	
S	T	I	N	A	K	U	R	E	R	A		
P	M	I	T	E	T	E	S	T	E	T	I	

**FJALËKRYQI (1)**

**FJALËKRYQI (2)**

**SUDOKU**

4			3	2				1	
	7	3			4	5			
	1		8		6	7			4
	8	6			2			4	
	3	7		4	9	1			
5		4	7					6	
			1			4			
	5						8	2	
6		8		5					

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

**Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar**

6	7	1	9	2	5	3	4	8
8	2	3	7	1	4	9	5	6
4	5	9	8	3	6	1	7	2
2	6	4	3	5	9	7	8	1
7	3	8	2	6	1	4	9	5
1	9	5	4	7	8	6	2	3
3	1	2	5	4	7	8	6	9
5	8	7	6	9	3	2	1	4
9	4	6	1	8	2	5	3	7

*Argëtim filozofik*

-Fjalët dhe punët e njerëzve të mëdhenj nuk janë sipas vendit të kohës së tyre, ata mund t'i përshatën çdo kohë dhe çdo vendi.

-Kush bazohet në forcën, bie për tokë po sa të thyhet forca, por ai që bazohet në drejtësinë, është i mbështetur në një godinë të fortë që nuk shembet kurrë.

-Askush nuk mund të parashikojë se në çfarë lartësisht mund të fluturosh. As vetë ti nuk do ta njohësh para se të hapësh krahët.

*Thënie të mëncura*

**KRIPTOSKEME**

**KRIPTOSKEME**

Përgjigja e numrit të djeshëm

4	6		8	3	6	10		10	4	16	3	2
10	3	9	5	7	4		8		6	12	4	
4	4		19	4	11	1	2	3	18	5	2	
18		11	5	6	5	13	5	9	4	7	3	2
5	12	3	2	5	6	3	2		9	5		5
		6	4	2	4		17		4	1	5	
5	2	3	3	3	7	2	2	5	4	6	1	
13	3	12	3	2	3		4	2	5	13	5	
2	13	16			2	3	E	5	12		2	5
17	12	4	1	12		7	M	6		2		13
5	4		7	4	8	I	1	12	5	6	4	2
9	13	8			2	17	R	4	8	2	3	2

V	A	P	E	N	I	V	O	D	K	A	
A	R	A	H	E	L	M	I	M	I	D	
T	I	P	E	R	I	O	D	I	K	A	
E	M	O	D	E	R	N	E	T	T	P	
R	E	I	D	I	I	O	A	O	T		
P	A	R	A	D	A	A	T	R			
P	R	A	E	A	K	I	L	O	N	I	
R	A	S	T	E	D	E	N	I	R	O	
O	L	E	L	E	S	T	E	T	T		
V	H	I	E	N	A	E	N	T	O		
A	R	I	A	N	E	T	R	R	A	P	
T	E	R	R	I	T	O	R	D	E	T	I

"Gjithkush duket se ka një ide të qartë se si të tjerët duhet të jetojnë jetën e tyre, por askush për të veten"

"Një ditë ne do të zbulojmë se ka shumë lumturi në lumturinë e tjetrit sesa në tonën".

- Shumë njerëz preferojnë që t'i lavdërojnë për veshjet e tyre, sesa për mirësinë, zgjuarsinë ose mençurinë.
- Zakonisht njerëzit grinden sepse nuk kanë aftësinë për të argumentuar.

